

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5872
E shtunë, 7 shtator 2019
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Dialogu
të rifillojë pa kushte,
Kosova është gati **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**PRESIDENTI THAÇI UDHËTON
TË DIELËN PËR NË JAPONI F. 3**

**LIMAJ: KOSOVA ËSHTË ME FAT
QË KA MIQ SI BRITANIA F. 7**

**GJYKATA SPECIALE FTON PËR
INTERVISTIM ISH-DEPUTETEN
SAFETE HADËRGJONAJ F. 4**

EKONOMI

**KOSOVA, PJSË E
MARRËVESHJES PËR
BASHKËPUNIM REGJIONAL
GJEOPËSINOR F. 8**

**ASK-ja: PAGAT NË KOSOVË NGA
VITI 2012 JANË RRRITUR PËR
29.6 PËR QIND F. 9**

SPORT



**CHALLANDESI: NA DUHET NJË
LOJË E ÇMENDUR PËR FITORE
NDAJ ÇEKISË F. 15**

**XHAKA: SHAQIRI MUND TA
KETË SHIRITIN E KAPITENIT F. 15**

FLET PËR "EPOKËN E RE", NASIM HARADINAJ **FAQE 4-5**



I gatshëm t'i bashkohem secilës parti

Nënkryetari i OVL-UÇK-së, Nasim Haradinaj, është shprehur i gatshëm t'i bashkohet secilës parti politike. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka treguar se mund t'i bashkohet çilido subjekt politik që e vlerëson të nevojshme ndihmën e tij. Haradinaj ka thënë se, ndonëse shokët i ka në PDK, nuk e ka problem të aderojë as në LDK nëse kjo e fton. Ai ka thënë se i pëlqen ideja e liderit të PDK-së për ta luftuar korrupsionin dhe nepotizmin, madje i ka ftuar të gjitha subjektet politike që në listat për deputetë të mos fusin njerëz me aktakuza

Shteti krenohet me policinë, premtion kushte më të mira

Policia e Kosovës ka mbrojtur integritetin territorial të vendit si dhe vazhdon të jetë institucioni më i besueshëm. Kështu është thënë të premtion nga liderët shtetërorë në ceremoninë e 20-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës. Sipas tyre, policia ka qenë simboli i besimit, sakrificës dhe përkushtimit për rend dhe ligj në dy dekadat e fundit. Ata kanë thënë se shteti i Kosovës e ka për obligim të krijojë kushte më të mira të punës për policët **FAQE 3**



Ish-deputetët që nuk garojnë në zgjedhjet e 6 tetorit **FAQE 7**

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit nuk do të garojnë për deputetë Aida Dërguti, Korab Sejdiu, Naser Osmani, Ilir Deda, Faton Topalli dhe Lutfi Zharku, të cilët kanë qenë pjesë e legjislaturës së kaluar. Për arsye të ndryshme ata kanë bërë me dije se nuk do ta sfidojnë veten në garën zgjedhore për deputetë



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

CDU/CSU në kërkim të pozicionit për Shqipërinë, Rama shkon në Berlin

BERLIN, 6 SHTATOR - CDU/CSU në Gjermani gjatë shtatorit do të përcaktojë pozicionin lidhur me procesin e negociatave BE-Shqipëri dhe gjatë javës së ardhshme do të ketë konsultime në Berlin, ku pritet të vijë edhe kryeministri shqiptar. Siç mësoi "Deutsche Welle" nga qarqet e CDU/CSU-së në Berlin, javën e ardhshme deputetët e grupit më të madh në Parlamentin gjerman (Bundestag), do të merren intensivisht me Shqipërinë, në kërkim të një qëndrimi për çeljen e negociatave.

Të përfshirë do të jenë kryesisht deputetët krisitandmeokratë e kristiansocialë të grupit të punës

së Ballkanit Perëndimor, i cili drejtohet nga nënkryetari i Grupit Parlamentar i CDU/CSU-së, Johann David Wadehul (CDU), si dhe grupet e punës për çështje të Bashkimit Evropian dhe të Jashtme. Gjatë javës së ardhshme ata pritet të takohen si me përfaqësues të Qeverisë gjermane, ashtu edhe me vetë kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Ky i fundit pritet të vijë të premten e ardhshme në Berlin. Siç duket, një pjesë e madhe e deputetëve të CDU/CSU-së janë të prirë t'i japin Shqipërisë një "Po me kushte", por ka edhe një pakicë të vogël, por të fortë, që mendon

se Shqipëria nuk është ende gati as për këtë. Përveç kushteve të formuluar edhe më parë në lidhje me reformën e gjyqësorit, krimin të organizuar dhe të drogës, reformën zgjedhore, pritet të shtohen edhe kushte të tilla si, sqarimi i ligjshmërisë së zgjedhjeve lokale të qershorit 2019, si edhe sqarimi i akuzave për shitblerjen e votave në disa zona. Vendimin përfundimtar grupi i CDU/CSU-së pritet ta marrë më 24 shtator. Qëndrimi i CDU/CSU-së duhet të jetë i njëjtë me atë të qeverisë gjermane dhe të partnerit të koalicionit SPD. Kjo e fundit,



dhe Ministria e Jashtme e drejtuar prej saj, është shprehur qysh më parë për një fillim të menjëhershëm të negociatave me Shqipërinë. Nëse palët

arrijnë t'i unifikojnë qëndrimet e tyre, pritet që më 27 shtator ky qëndrim të votohet në seancën plenare të Bundestagut.

Senatorët amerikanë: Kosova dhe Serbia duhet të japin e të marrin në bisedime

Senatori amerikan Ron Johnson tha se "ne duam të bëjmë gjithçka që është e mundur për t'i mbështetur të dy vendet në bisedimet e tyre në të cilat duhet të marrin dhe të japin dhe kur të arrihet marrëveshja, përfitimet për të dyja palët do të jenë shumë të mira"



BEOGRAD, 6 SHTATOR - Senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Ron Johnson thanë të premten në Beograd se Kosova dhe Serbia duhet të bëjnë sakrificë për ta siguruar normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Të dy senatorët qëndruan në Beograd, dy ditë pasi kishin vizituar Prishtinën, për ta dërguar mesazhin se Shtetet e Bashkuara mbështesin rifillimin e bisedimeve dhe arrijnë e një marrëveshjeje ndërmjet palëve. "Ne duam të bëjmë gjithçka që është e mundur për t'i mbështetur të dy vendet në bisedimet e tyre në të cilat duhet të marrin dhe të japin", tha senatori Johnson duke nënvizuar se kur të arrihet

marrëveshja, përfitimet për të dyja palët do të jenë shumë të mira. "Duhet sakrificë dhe kompromise në të dyja anët. Shpresojmë që pas zgjedhjeve në Kosovë do të ndërmerren hapat e domosdoshëm për t'i rifilluar bisedimet", tha senatori Murphy, duke shtuar se Shtetet e Bashkuara janë të gatshme t'i ndihmojnë palët qoftë me këshilla gjatë procesit, qoftë duke i mbështetur ato pas arrijtes së marrëveshjes. Ai tha se palët duhet ta kenë hapësirën e mjaftueshme për të arritur një marrëveshje të pranueshme për to.

Bisedimet janë pezulluar që nga nëntori i vitit të kaluar kur

Prishtina u vuri tarifa prej 100 përqindësh mallrave serbe në shenjë kundërshtimi ndaj fushatës së Beogradit kundër shtetësisë së Kosovës. Presidenti serb Aleksandër Vuçiq tha se Beogradi pret heqjen e taksës dhe kërkon një marrëveshje kompromisi. "Nëse nuk ka një zgjidhje kompromisi, ne nuk mund ta njohim pavarësinë e Kosovës. Dhe, këtu nuk ka

filozofi të madhe", tha ai. Vizita e dy senatorëve në Ballkan ndodh pak ditë pasi që sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, emëroi zëvendësndihmësin e tij, Matthew Palmer, si Përfaqësuesin e Posaçëm për Ballkanin Perëndimor. Emërimi i tij shihet si një dëshmi e përfshirjes më të madhe të Shteteve të Bashkuara në procesin e bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe

Serbisë. Vazhdimi i këtyre bisedimeve mund të pritet pas zgjedhjeve të parakohshme në Kosovë, që mbahen më 6 tetor. Diplomatat shpresojnë që një qeveri e re të formohet shpejt pas këtyre zgjedhjeve dhe të rihapin bisedimet para se Serbia të hyjë në periudhën e zgjedhjeve që mbahen në pranverën e vitit të ardhshëm.

Meta, të hënën para Komisionit Hetimor

TIRANË, 6 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka konfirmuar se do të jetë në Kuvend për të marrë pjesë në Komisionin Hetimor, në lidhje me qëndrimin për dekretin e tij për rrëzimin e 30 qershorit si datë të zgjedhjeve vendore. Të premten, zëdhënësi i presidentit, Tedi Blushi, sqaroi se kreu i shtetit do të jetë në Kuvend ditën e hënë.

Përmes një postimi në "Facebook", Blushi shkroi se kreu i shtetit më 9 shtator (e hënë) do të jetë në Kuvend, në një orar të përpiktë, madje 1 minutë para orarit

zyrtar kur ai është kërkuar. "Të dashur kolegë gazetarë që vazhdoni të më pyesni nëse do të shkojë apo jo presidenti Meta në Parlament, ju konfirmoj me përgjegjshmëri maksimale, se ditën e hënë, presidenti Meta, në orën 09:59 do të jetë në Parlament", shkruan Blushi.

Kuvendi vendosi të thërrasë Metën në Komisionin Hetimor më 9 shtator. Madje, presidentit tha se mezi po priste që të kthehej në Kuvend. Plani hetimor që do të ndjekë mazhoranca, i miratuar nga komisioni, në thelb synon hetimin e

shkeljeve të mundshme të Kreut të Shtetit në lidhje me zhdukimin e zgjedhjeve të 30 qershorit, datë kjo që shkaktoi reagime të forta dhe përplasje mes subjekteve politike. Hapi i parë procedural që do të ndiqet është seanca dëgjimore me presidentin e Republikës, në zbatim të nenit 112, pika 3 të Rregullores së Kuvendit. Por OSBE/ODIHR deklaroi se votimet e 30 qershorit ishin joligjore dhe se kryeministri shkeli ligjin kur nuk publikoi në Fletoren Zyrtare dekretin për 13 tetorin si datë zgjedhesh.



Policia e Republikës së Kosovës ka shënuar 20-vjetorin e themelimit

Shteti krenohet me policinë, premtion kushte më të mira

Policia e Kosovës ka mbrojtur integritetin territorial të vendit si dhe vazhdon të jetë institucioni më i besueshëm. Kështu është thënë të premtion nga liderët shtetërorë në ceremoninë e 20-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës. Sipas tyre, policia ka qenë simbol i besimit, sakrificës dhe përkushtimit për rend dhe ligj në dy dekadat e fundit. Ata kanë thënë se shteti i Kosovës e ka për obligim të krijojë kushte më të mira të punës për policët



EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Policia e Republikës së Kosovës të premtion ka shënuar 20-vjetorin e themelimit në një ceremoni solemne ku të pranishëm kanë qenë drejtuesit më të lartë shtetërorë të cilët kanë vlerësuar lart punën e këtij institucioni. Me këtë rast drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se gjatë këtyre dy dekadave policia ka arritur të jetë institucioni më i besuar për qytetarët e Kosovës. Ai ka vlerësuar se sukseset e policisë janë arritur falë bashkëpunimit me faktorin ndërkombëtar. "Është nder i madh të flas në emër të Policisë së Kosovës sepse policia është e lidhur ngushtë me të arriturat e vendit. Policia u ngrre me përkrahjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Ndihej krenar me punën e palodhshme të Policisë së Kosovës. Falënderoj zyrtarët e OSBE-së, zyrtarët e UNMIK-ut, EULEX-in e të tjerët që kontribuan

për Policinë e Kosovës. Në polici nuk ka probleme, ka vetëm zgjidhje të tyre", ka deklaruar ai, duke shprehur përkushtimin e Policisë së Kosovës për të ofruar siguri dhe zbatim të ligjit për të gjithë qytetarët. "Jemi partner i besueshëm në zbatimin e ligjit dhe do të ofrojmë siguri për qytetarët. Policia ka dëshmuar që është e gatshme të përballon me sukses në të gjitha format në përgjithësi. Sakrifica e policëve të rënë na forcon që ta ndjekim punën tonë me paanshmëri dhe ndershmëri", është shprehur Qalaj.

Ndërsa ministri në largim i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka thënë se do të jetë përherë në mbështetje të Policisë së Kosovës. "Policia e Kosovës është institucioni më i besueshëm në vend. Urime përvjetori jubilar dhe ju siguroj se gjithmonë do ta keni përkrahjen time!", ka theksuar Mustafa.

Kurse presidenti Hashim Thaçi, duke vlerësuar të arriturat e Policisë së Kosovës gjatë këtyre 20 vjetëve, ka thënë se policia është

një histori suksesi e shtetit. "Policia e Kosovës ishte ajo që mbrojti integritetin territorial të Kosovës, veprim ky historik dhe i guximshëm. Policët e Kosovës kanë qenë simbol i besimit, sakrificës dhe përkushtimit të pakontestueshëm për rend dhe ligj në 20 vjetët e fundit. Ky rrugëtim dy dekadash ishte plot sfida, por asnjëherë nuk mungoi gatishmëria e policëve tanë për ta sakrifkuar edhe jetën në përmbushje të betimit të dhënë për mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve tanë. Në këtë 20-vjetor e kujtojmë Enver Zymerin dhe dhjetëra policë të rënë në krye të detyrës. Shteti i Kosovës e ka për obligim që të krijojë kushte më të mira të punës për policët tanë", ka deklaruar Thaçi.

Ndërsa ish-kryetari i Kuvendit,

Kadri Veseli, ka thënë se policia dhe ushtria e Kosovës janë ndër institucionet më profesionale dhe më të pakorruptuarat në vend. Ai ka deklaruar se uniforma e Policisë së Kosovës që dy dekada është uniformë që e nderon vendin. "Përkushtimi, profesionalizmi dhe sakrifica e madhe ishin gjithmonë standarde që e veçuan Policinë e Kosovës. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, për të cilën ranë në krye të detyrës dhjetëra policë, është luftë për ta fuqizuar shtetin e së drejtës dhe për t'i hapur rrugë zhvillimit ekonomik. Roli i policisë në këtë drejtim është primar. Liria dhe siguria nuk bëjnë pa njëra-tjetrën dhe zhvillimi ekonomik u jep kuptim të dyjave. Ky është vizioni ynë për të ecur përpara", ka theksuar Veseli.

Ndërkaq kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka thënë se Policia e Kosovës është partnere e mirë në luftimin e krimit në rajon. Ai ka thënë se policia e meriton të jetë në Interpol dhe kushdo që e pengon anëtarësimin e saj po e rrezikon sigurinë botërore. "Kur shoh para meje Policinë e Kosovës, këta burra e gra që i shërbejnë atdheut sypatrembur, e shoh Kosovën 100 % shtet. Policia jonë është shembulli më i mirë se çka simbolizon Kosova, çka është shteti e si duhet të mbrohet ai. Paga e orëve shtesë, rritja e pagave dhe e buxhetit, janë vetëm fillimi i një përkushtimi të plotë. Bashkë do të jemi përherë, në sfida dhe suksese! Urime

ditëlindja e 20!", është shprehur Haradinaj.

Në këtë përvjetor jubilar ka folur edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett. Ai ka ofruar mbështetjen e Amerikës për forcimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës. "Qytetarët e vlerësojnë Policinë e Kosovës si një ndër institucionet më të besueshme. Policia ka shtuar pjesëmarrjen e grave në 15 %. Rreth 60 % e policisë shprehet se i flet të dyja gjuhët, shqipe dhe atë serbe. Policia po punon që ta sigurojë sigurinë në tërë vendin", ka deklaruar Kosnett.

Edhe shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan Brathu, ka shprehur përkushtimin për ta vazhduar mbështetjen për forcimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës për ta luftuar krimin e organizuar. "Është kënaqësi dhe nder të jem këtu për ta festuar 20-vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës. Ne e mbështesim forcimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës në mënyrë që detyrat t'i kryejë me sukses. OSBE-ja e çmon shumë konceptin e policisë në komunitet sepse përmes policisë në komunitet ju jeni të parët që mund t'i vëreni krimet dhe terrorizmin", ka theksuar ai. Në përvjetorin jubilar të themelimit të policisë, presidenti ka nderuar me medaljen presidenciale drejtorin e parë të Shkollës së Policisë në Kosovë, Stiv Benet.

Me medalje janë nderuar edhe disa prej pjesëtarëve më të dalluar të Policisë së Kosovës.



Presidenti Thaçi udhëton të dielën për në Japoni

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të dielën do të udhëtojë për një vizitë zyrtare disaditore në Japoni. Thaçi do të zhvillojë takime me krerët më të lartë shtetërore

për ta shtyrë përpara agjendën e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve.

Gjatë kësaj vizite presidenti Thaçi do të pritë nga Lartmadhëria e tij, Perandori i Japonisë. Po ashtu, do

të pritë edhe nga kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, me të cilin do të ketë edhe një drekë punë pas takimit bilateral. Kjo vizitë e presidentit Thaçi në Japoni vjen tash kur dy vendet janë duke kremtuar

10-vjetorin e lidhjes së marrëdhënies diplomatike. Vizita zyrtare ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit bilateral dhe zgjerimin e shkëmbimit tregtar ndërmjet dy vendeve tona.



Flet për "Epokën e re", Nasim Haradinaj

I gatshëm t'i bashk



Nënkryetari i OVL-UÇK-së, Nasim Haradinaj, është shprehur i gatshëm t'i bashkohet secilës parti politike. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka treguar se mund t'i bashkohet cilido subjekt politik që e vlerëson të nevojshme ndihmën e tij. Haradinaj ka thënë se, ndonëse shokët i ka në PDK, nuk e ka problem të aderojë as në LDK nëse kjo e fton. Ai ka thënë se i pëlqen ideja e liderit të PDK-së për ta luftuar korrupsionin dhe nepotizmin, madje i ka ftuar të gjitha subjektet politike që në listat për deputetë të mos fusin njerëz me aktakuza

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Nënkryetari i OVL-UÇK-së, Nasim Haradinaj, ka thënë se ende nuk ka vendosur për t'iu bashkuar ndonjë partie politike për zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka bërë me dije se është i gatshëm ta ndihmojë secilin subjekt politik nëse e shohin të nevojshme një gjë të tillë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Haradinaj ka thënë se nëse aderon në ndonjë parti këtë nuk e bën për ndonjë

përfitim personal. "Cilësdo parti që ia merr mendja se i duhet Nasim Haradinaj, unë jam i gatshëm t'i ndihmoj atij subjektit politik. Por, të gjithë duhet ta dinë se unë nuk bëhem vegël e liderit. Të gjithë e dinë se unë një herë kam kaluar nga PDK-ja në AAK, por kam aderuar kur kjo parti ka qenë në opozitë. Pra, nuk jam prej atyre tipave që vrapon aty ku mund të marrë ndonjë post, por kam shkuar aty ku ka nevojë për ndihmë", ka thënë Haradinaj. Ai ka sqaruar raportimet e

fundit nëpër medie se do të bëhet pjesë e PDK-së. "Ajo që ka ndodhur ka qenë një bisedë shoqërore me disa shokë që ishin pjesë e OVL-UÇK-së, në një restorant privat, ku diskutim për çështjet politike. Dhe unë, në diskutim e sipër, thashë se, meqenëse krejt partitë politike iu kanë vërsulur PDK-së, duke i vendosur vija të kuqe, atëherë do të ishte mirë t'i ndihmoj PDK-së, sepse ka nevojë për ndihmë", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se nëse lidhshipi i kësaj partie e sheh të nevojshme ndihmën e tij në

Haradinaj: Dialogu të rifillojë pa kushte, Kosova është gati

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë të premten se dialogu ndërmjet Kosovës


dhe Serbisë duhet të rifillojë pa kushte. Ai ka deklaruar se Kosova ndan interesimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

(ShBA). "Kosova ndan interesimin strategjik me Shtetet e Bashkuara për paqe dhe stabilitet në Ballkan, që arrihet kur

Kosova dhe Serbia njohin njëra-tjetrën me kufijtë ekzistues", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Twitter".



Epokën secilën parti



"Epoka e re": Z. Haradinaj, kohën e fundit është raportuar se do t'i bashkoheni PDK-së. Është e vërtetë?

Haradinaj: E vërteta është se unë nuk kam menduar diçka konkrete për t'iu bashkuar PDK-së. Ajo që ka ndodhur ka qenë një bisedë shoqërore me disa shokë që ishin pjesë e OVL-UÇK-së, në një restorant privat, ku diskutonim për çështjet aktuale politike. Dhe unë, në diskutim e sipër, thashë se meqenëse krejt partitë politike iu kanë vërsulur PDK-së, duke i vendosur vija të kuqe, atëherë do të ishte mirë t'i ndihmoj PDK-së, sepse ka nevojë për ndihmë. Këto parti asnjëherë nuk i vendosin vija të kuqe Listës Serbe, por PDK-së. Në këtë mënyrë, më parë do të pranoja me qenë opozitë me PDK-në sesa ministër me Ramush Haradinajn apo dikë tjetër. Sepse ato ma kujtojnë kohën e vitit 1981, kur na linçonin ne aktivistëve që ishim për Lëvizjen për bashkim dhe Republikë të Kosovës. Rastësisht në atë ndejë kish qenë një gazetar dhe ai nuk kishte ndryshuar asgjë nga ato që kam thënë unë. E keqja është se ai atë e ka bërë në mënyrë tinëzare, sepse nuk është fer kur disa shokë bisedojnë dhe dikush tjetër i përdor ato biseda. Gazetarin që e ka bërë atë lajm e çmoj për korrektësinë, sepse e ka prezantuar krejt atë që e kam thënë, por nuk e çmoj për mënyrën tinëzare.

"Epoka e re": A jeni i gatshëm t'i bashkoheni ndonjë partie politike?

Haradinaj: E kam thënë edhe më herë, se cilësdo parti që ia merr mendja se i duhet Nasim Haradinaj unë jam i gatshëm t'i ndihmoj. Por, të gjithë duhet ta dinë se unë nuk bëhem vegël e liderit. Të gjithë e dinë se unë një herë kam kaluar nga PDK-ja në AAK, por kam aderuar kur kjo parti ka qenë në opozitë. Pra, nuk jam prej atyre tipave që vrapon aty ku mund të marrë ndonjë post, por kam shkuar aty ku ka nevojë për ndihmë. Meqenëse tash të gjithë dolën kundër PDK-së dhe po mendojnë se këtë parti do ta dërgojnë në shtëpi, nëse shokët e mi e shohin të

arsyeshme që mund t'i ndihmoj PDK-së, unë jam i gatshëm, sepse unë kam qenë ndër themeluesit e saj. Por, pa pazare. Mendoj se vendosja e vijave të kuqe ndaj një subjekti është e padrejtë, sepse asnjëra prej këtyre partive nuk thotë se do t'i qesë vijë të kuqe Listës Serbe. Pra, të gjitha ato e lanë mundësinë se do ta bëjnë qeverinë me Listën Serbe sikurse e bënë qeverinë e kaluar.

"Epoka e re": Pra, jeni i gatshëm t'i bashkoheni PDK-së pa asnjë interes?

Haradinaj: Nëse ata e shohin se jam i nevojshëm për t'i ndihmuar, unë jam i gatshëm të marr secilën detyrë apo mision që ma japin.

"Epoka e re": Po nëse ju vjen ndonjë ftesë prej partive të tjera, a do t'u bashkoheni atyre?

Haradinaj: Po, ama jo me çmime. Edhe nëse LDK-ja më kërkon ndihmë, shkoj, pse jo. Në këtë rast kam thënë për PDK-në vetëm pse të gjitha partitë e tjera e kanë sulmuar PDK-në. Unë mendoj se asnjëra prej këtyre partive nuk është më pak fajtores se tjera.

"Epoka e re": Siç po shihet në këto zgjedhje fjali kryesore e PDK-së do të jetë "lufta kundër krimin dhe korrupsionit". Si e keni këtë përpjekje të PDK-së?

Haradinaj: Me pëlqen ideja për kandidimin e njerëzve për deputetë të cilat nuk kanë aktakuza. Nëse kësaj i përmbahet deri në fund lideri i PDK-së, atëherë unë edhe më me qejf i bashkohem këtij subjekti politik.

"Epoka e re": Katër subjekte politike janë konkurrenca për t'i fituar zgjedhjet. Kush mendoni se do të dalë fitues në zgjedhjet e 6 tetorit?

Haradinaj: Më fal, por unë nuk merrem me parashikime dhe me analiza. Nuk di me qit fall. Mendoj se këto zgjedhje do të jenë interesante, me befasi për të gjithë. Ndoshta sulmi që partitë e tjera po ia bëjnë PDK-së do të ndikojë që kjo parti të bashkohet më shumë. Por, ndoshta, është edhe koha të bëhen ndryshime. Të bëhen

ndryshime nuk do të thotë të vijë një parti e re në pushtet. Ndryshimi do të ishte edhe mos të përfshihen njerëzit me aktakuza në listat për deputetë. Nëse ndodh kjo, ata e fyejnë partinë dhe votuesit.

"Epoka e re": Pra, askush prej partive politike s'duhet të ketë në lista kandidatë me aktakuza?

Haradinaj: Mendoj se subjektet politike më herët është dashur që në lista të mos fusin njerëz me aktakuza. Deri më tani të gjitha subjektet kanë pasur në brendësinë e tyre njerëz me aktakuza. Uroj që të gjitha ta ndjekin këtë ide të PDK-së, që askush mos të ketë kandidatë me aktakuza, sepse vetëm atëherë do të kemi një përfaqësim të denjë dhe një shpresë se diçka po ndodh në Kosovë.

"Epoka e re": Meqenëse jemi parazgjedhjeve, pothuajse të gjitha subjektet politike do t'i kenë target edhe veteranët e UÇK-së. Cili është mesazhi juaj për ta?

Haradinaj: Veteranët e UÇK-së kanë një atdhe, veteranët e UÇK-së kanë primar shtetin e Kosovës, ata nuk e mbështesin dhe nuk e kanë mbështetur askënd. Ne kemi qenë kundër demarkacionit dhe kundër Gjykatës Speciale. Mendoj se do të vijnë forca të reja që nuk do të votojnë më ligje ashtu siç u thuhet, sidomos nuk do ta votojnë vazhdimin e Gjykatës Speciale dhe do ta thonë troç se demarkacioni është tradhti.

"Epoka e re": Në këto zgjedhje OVL-UÇK nuk e mbështet asnjë parti politike?

Haradinaj: Veteranët e luftës së UÇK-së janë nëpër të gjitha subjektet politike, mirëpo në qëndrimet kryesore për kombin dhe shtetin, ne aty si veteranë jemi bashkë të gjithë. Shpresoj se në këto zgjedhje të fitoj më i miri. Mendoj se është koha të jepet sinjali se njerëzit e korruptuar dhe ata që i kanë bërë dëme Kosovës të anashkalohehen. Po ashtu, mendoj se edhe këta deputetë e deritashëm janë plakur në politikë. Është koha të vazhdohet me njerëz të ri.

këto zgjedhje, ai është i gatshëm t'i bashkohet. "Meqenëse tash të gjithë dolën kundër PDK-së dhe po mendojnë se këtë parti do ta dërgojnë në shtëpi, nëse shokët e mi e shohin të arsyeshme që mund t'i ndihmoj PDK-së, unë jam i gatshëm, sepse kam qenë ndër themeluesit e saj", ka thënë Haradinaj. Ai ka thënë se nuk e ka problem t'i bashkohet as Lidhjes Demokratike të Kosovës. Haradinaj i ka ftuar të gjitha subjektet politike që në listat për deputetë të mos fusin

njerëz me aktakuza. Sipas tij, vetëm atëherë do të rritej shpresa se po ndodh diçka pozitive në Kosovë. "Mendoj se subjektet politike më herët është dashur që në lista të mos fusin njerëz me aktakuza. Deri më tani të gjitha subjektet në brendësinë e tyre kanë pasur njerëz me aktakuza. Uroj që të gjitha ato ta ndjekin këtë ide të PDK-së, që asnjëra mos të ketë kandidatë me aktakuza, sepse vetëm atëherë do të kemi përfaqësim të denjë dhe shpresë se diçka po ndodh në Kosovë", ka thënë Haradinaj

Gjykata Speciale fton për intervistim ish-deputeten Safete Hadërgjonaj

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Gjykata Speciale me seli në Hagë e ka ftuar edhe deputeten e Kuvendit të Kosovës nga rad-

hët e PDK-së, Safete Hadërgjonaj, për intervistim në cilësinë e dëshmitares. Lajmin e ka bërë me dije për

"Epokën e re" vetë Hadërgjonaj. Ajo do të intervistohet për periudhën 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor

2000. Deputetja Hadërgjonaj, sipas ftesës që ka marrë, do të intervistohet më 19 shtator nga Specialja.



Januz Salihaj i bashkohet PDK-së

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Eksperti i arsimit dhe ish-ministri Januz Salihaj të premten është bërë pjesë e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se kjo parti si familje e madhe politike di t'i çmojë njerëzit e guximshëm dhe parimorë dhe ta vlerësojë mendimin ndryshe. Ai ka thënë se Salihaj tani e tutje do ta japë kontributin në PDK, në luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit. "Rrugët me PDK-në i bashkoi edhe ish-ministri Januz Salihaj, ekspert i arsimit në

vendin tonë. Si familje e madhe politike dimë t'i çmojmë njerëzit e guximshëm dhe parimorë dhe ta vlerësojmë mendimin ndryshe. Januzi i kishte kundërshtuar gjithmonë përpjekjet politike për të sistemuar njerëz mbi bazën e nepotizmit në Komunën e Prishtinës. Jemi të lumtur që ai tani do ta japë kontributin e tij si pjesë e PDK-së në luftën tonë të pakompromis kundër korrupsionit dhe nepotizmit", ka thënë Veseli pas aderimit të Januz Salihajt në PDK.



Vetëvendosjes i bashkohet kirurgu Valdet Januzaj



PRISHTINË, 6 SHTATOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se kësaj lëvizje të premten i është bashkuar kirurgu Valdet Januzaj. Ai ka thënë se Januzaj është me prejardhje nga Istogu, por që nga viti 1991 ka jetuar në Perëndim. Sipas Kurtit, Kosova ka nevojë për njerëz si Valdeti që janë të gatshëm të kthehen e të investojnë këtu, por edhe për Lëvizjen tonë, qeverisja e së cilës do të krijojë lehtësime për investime të mërgatës në Kosovë.

"Kushtet për investime në vendet e Bashkimit Evropian ishin shumë më të favorshme, mirëpo Valdeti që nga viti 2004 filloi tërheqjen e këtyre investimeve me qëllim kthimin në Kosovë. Investimet janë bërë kryesisht në 3 sektorë: shëndetësi, hotelieri, si dhe në projekte të infrastrukturës. Para pesë vjetësh ka realizuar atë që gjithmonë e ka synuar, kthimin e përhershëm për të jetuar dhe vepruar në Kosovë. Për më tepër se kaq, Valdeti ka vendosur që kon-

tributin më të madh për Kosovën ta japë pikërisht përmes angazhimit në Lëvizjen Vetëvendosje ku edhe zyrtarisht u anëtarësua. E mirëprita bashkë me kryetarin e Qendrës sonë në Istog, Agron Avdijaj. Kosova ka nevojë për njerëz si Valdeti që janë të gatshëm të kthehen e të investojnë këtu, por edhe për Lëvizjen tonë, qeverisja e së cilës do të krijojë lehtësime për investime të mërgatës në Kosovë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Përurohët rinovimi i Klinikës së Endokrinologjisë

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, i shoqëruar nga drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, kanë përfunduar të premten rinovimin e Klinikës së Endokrinologjisë në QKUK. Ministri Ismaili ka thënë se reformat në sektorin shëndetësor po bëhen falë luftës së madhe ndaj korrupsionit. "Është kënaqësi të shohësh se fondet të cilat nuk abuzohen më tani kthehen në investime direkte për qytetarët dhe për personelin shëndetësor. Bashkëdyzimi i vullnetit dhe energjisë ka arritur që të krijojë sot një klinikë me të cilën realisht mund të jemi krenarë", ka thënë ai. Ismaili ka përgëzuar edhe menaxhmentin e Klinikës së Endokrinologjisë për ofrimin e shërbimeve më të mira për pacientë. Ndërsa drejtori i ShSKUK-së,

Basri Sejdiu, ka thënë se të gjitha reformat po bëhen për të mirën e pacientëve. "Në këto ambiente tashmë ka hapësira moderne për mjekimin e pacientëve. Këto janë rezultatet kur, krahas mbështetjes institucionale, ka edhe një rol proaktiv të menaxhmentit të klinikës për t'i përmirësuar kushtet", ka thënë Sejdiu. Kurse drejtoresha e Klinikës së Endokrinologjisë, Venera Berisha-Muharremi, ka thënë se ky është një investim që ka ndryshuar tërësisht shërbimet për pacientë. "Klinika jonë tani ka një infrastrukturë moderne dhe të gatshme për të gjitha shërbimet ndaj pacientëve", ka thënë ajo. Kjo klinikë, përveç ngjyrosjes, ndërrimit të dyshemesë, ndërtimit të pritores së re, modernizimit të sallës së edukimit, ka siguruar edhe



televizor për secilën dhomë të pacientëve. Po ashtu, secili

shtrat i ri i pacientëve e ka edhe butonin e vet për ta thirrur infer-

mieren në rast të ndonjë kërkesë.

ShKK-ja: Një i burgosur ka bërë vetëvrasje në Dubravë

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se në mbrëmjen e së enjtes ka bërë vetëvrasje një i burgosur (F.I).

ShKK-ja ka treguar se i burgosuri ka bërë vetëvarje me jelekun e vet në grilat prapa derës së dhomës së qelisë. "Rreth orës 20:15 në Qendrën Korrektuese në Dubravë ka bërë vetëvarje me jelekun e vet,

në grilat prapa derës së dhomës së qelisë, i burgosuri me inicialet F.I. Me të kuptuar për rastin, i menjëhershëm ka qenë intervenimi i stafit korrektues dhe atij mjekësor të burgut por,

përkundër përpjekjeve për reanimim, nuk kanë arritur të kthejnë në jetë dhe, si pasojë, ai ka ndërëruar jetë. Personi në fjalë ishte i dënuar për veprën penale: lëndim i rëndë trupor", është

thënë në komunikatë. ShKK-ja ka bërë me dije se për rastin janë njoftuar Policia e Kosovës dhe prokurori, të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe po e hetojnë rastin.

Partitë politike i kanë dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) listat me kandidatë për deputetë

Ish-deputetët që nuk garojnë në zgjedhjet e 6 tetorit



Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit nuk do të garojnë për deputetë Aida Dërguti, Korab Sejdiu, Naser Osmani, Ilir Deda, Faton Topalli dhe Lutfi Zharku, të cilët kanë qenë pjesë e legjislaturës së kaluar. Për arsye të ndryshme ata kanë bërë me dije se nuk do ta sfidojnë veten në garën zgjedhore për deputetë

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Gjashtë deputetët e legjislaturës së VI-të, Aida Dërguti, Korab Sejdiu, Naser Osmani, Ilir Deda, Faton Topalli dhe Lutfi Zharku, nuk do të garojnë edhe për një mandat në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Ish-deputetja dhe nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Socialdemokrate (PSD), Aida Dërguti, ka bërë me dije se nuk do të jetë pjesë e listës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme. Megjithatë, ajo nuk ka treguar arsyen pse ka hequr dorë nga kandidatura. "Në këtë kohë aderimesh nëpër parti e lista zgjedhore, kur rëndom shumica e fillojnë angazhimin politik, më duhet t'u njoftoj se

nuk do të jem pjesë e asnjë liste zgjedhore. Për të shmangur çdo spekulim mediatik, vota ime do të shkojë për kandidatët e PSD-së. Kësaj radhe po i bashkohem sovranit. Ju faleminderit të gjithëve që më keni mbështetur", ka shkruar Dërguti në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe bashkëpartiaqi i saj Faton Topalli nuk do të jetë pjesë e listës zgjedhore të PSD-së për këto zgjedhje. Nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ai ka treguar se arsyet e moskandidimit të tij janë personale. "Nuk do të jem kandidat. Tani kur po përpilohen listat e partive politike për deputetë, dua t'u njoftoj që nuk do të jam pjesë e listës së koalicionit PSD-AAK. Arsyet e moskandidimit tim janë personale. Unë do të vazhdoj të jem pjesë e Partisë Socialdemokrate, së cilës

ia kam falur gjithë besimin tim dhe prej së cilës jam emëruar drejtues i Shtabit Zgjedhor për Ferizaj dhe drejtues i Shtabit Rajonal për zgjedhjet e vitit 2019. Pra, do të jem 100 % në shërbim të Kosovës, 100 % në shërbim të PSD-së", ka deklaruar Topalli, duke uruar që legjislatura e shtatë të jetë më e mirë se kjo e fundit. "Uroj që kjo legjislaturë të jap shembullin që PSD po tenton ta instalojë në politikë: debatin pa sharje e fyerje, debatin konstruktiv dhe sjelljen me etikë dhe integritet", ka theksuar ai. Edhe ish-deputeti nga LDK-ja, Lutfi Zharku, ka vendosur mos të kandidojë për deputet në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare më 6 tetor. Ai ka thënë se këtë vendim e ka marrë për t'i hapur rrugë kuadrove të reja të cilat çojnë në forcimin e mëtejshëm të LDK-së në Kaçanik dhe më gjerë. "Në mbledhjen e kryesisë së Degës së LDK-së në Kaçanik i kam njoftuar me qëndrimin tim që mos të kandidoj për deputet në Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale që mbahen më 6 tetor. Jam më se i lumtur që të gjithë kanë insistuar që unë të garoj edhe për një mandat duke më ofruar përkrahje edhe më të madhe se më parë, por i sigurova se moskandidimi im pas 5 man-

datave është vullneti i sqertë për hapje të rrugës për kuadro të reja që çojnë në forcimin e mëtejshëm të LDK-së në Kaçanik dhe më gjerë", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe ish-deputeti i LDK-së, Naser Osmani, ka bërë me dije se nuk do të jetë pjesë e listës së partisë në garën për deputet në zgjedhjet e 6 tetorit. "Të dashur qytetarë, si përfaqësues i juaji në gjashtë legjislatura, kam mbrojtur me nder interesin e përgjithshëm dhe kam bërë më të mirën e mundshme. Duke e vlerësuar pafundësisht besimin që më keni dhënë dhe për të garantuar proces gjyqësor pa asnjë ndikim dhe pas asnjë dyshim, kam vendosur që, përkundër propozimit nga Dega e Lipjanit, të mos jem pjesë e listës së LDK-së, partisë sime të përjetshme", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook". Në zgjedhjet e 6 tetorit nuk do të garojë as ish-deputeti i partisë Alternativa, Ilir Deda. Këtë e ka bërë me dije vetë ai përmes një postimi në profilin e tij në "Facebook". "Në vend se të jetë fitorja politike e Kosovës prioritet, te ne është më e rëndësishme fitorja partiake individuale. Prandaj, unë refuzoj të jem pjesë e kësaj lloj politike, esencialisht primitive dhe skajshmërisht të

papërgjegjshme", ka thënë ai, duke shtuar se zgjedhjet e 6 tetorit po shndërrohen në përplasje militantësh në një anë dhe tentim për mbijetesë politike në anën tjetër. Edhe ish-deputeti i pavarur, Korab Sejdiu, ka bërë me dije se nuk do të garojë për deputet në zgjedhjet e parakohshme. "Jam tepër mirënjohës për ofertat e jashtëzakonshme të bashkëpunimit që më kanë ofruar LDK-ja dhe IV-ja, të cilat tregojnë për qëllimin e këtyre dy partive (që do të doja të kishin garuar bashkë) që qeveria e ardhshme të ketë njerëz të vullnetit të mirë që kanë synim të vetëm një Kosovë të përparuar dhe jetë të mirë për qytetarët e saj. Pavarësisht nga kjo, kryesisht për arsye të natyrës personale/familjare, unë kam marrë vendimin jo të lehtë që të mos kandidoj edhe për një mandat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës", ka shkruar Sejdiu në llogarinë e vet në "Facebook". Jo zyrtarisht gazeta ka marrë vesh se pjesë e listave zgjedhore nuk do të jenë edhe disa ish-deputetë të legjislaturës së kaluar. Ndërkohë, subjektet politike mesnatën e së premtes i kanë dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) listat me kandidatë për deputetë.

Limaj: Kosova është me fat që ka miq si Britaninë

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Zëvendëskryeministri në detyrë i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, të cilit i ka uruar mirëseardhje në Kosovë. Limaj dhe Abbott kanë biseduar për zhvillimet aktuale në vend, me theks të veçantë zgjedhjet e parakohshme që mbahen më 6 tetor. Ai ka thënë se Kosova është me fat që ka miq si

Mbretëria e Bashkuar e cila e ka ndihmuar Kosovën në të gjitha proceset. "Pata kënaqësinë ta prisja në takim njoftues ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, të cilit i urova mirëseardhje në Kosovë. Me ambasadorin britanik biseduam për zhvillimet aktuale në vend, me theks të veçantë zgjedhjet e parakohshme që pritet të mbahen më 6 tetor në Kosovë. Kosova është me fat që ka miq

të tillë siç është Mbretëria e Bashkuar e cila e ka ndihmuar Kosovën në të gjitha proceset që ka kaluar vendi ynë. Në këtë takim me ambasadorin potencova bashkëpunimin dhe ndihmën e jashtëzakonshme që vendi ynë ka me Mbretërinë e Bashkuar. Jam i bindur që ky bashkëpunim dhe ndihma e ambasadorit Nicholas Abbott në proceset që do të kalojë Kosova do të vazhdojë si deri më tani", ka deklaruar Limaj.



Dogana: Do të gjobiten të gjitha ata persona që ua shtojnë kilometrat veturave

PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Dogana e Kosovës ka bërë me dije se disa pronarë të veturave janë duke vazhduar të mashtrorin me kilometrat e kaluara të veturave të tyre në mënyrë që t'u ikin pagesave më të larta në doganë. Për këtë rast, Dogana e Kosovës ka theksuar se do të aplikohen gjoba financiare ndaj të gjithë atyre që ia rrisin kilometrat veturave të veta. "Dogana e Kosovës i informon të gjithë qytetarët se është duke hasur në raste kur kilometrat e veturave të përdorura rriten me qëllim të tentimit të pagesës më të ulët. Kodi doganor i Kosovës, neni 276,

për shkak të shmangieve në detyrimet doganore, aplikon gjoba financiare ndaj personave që i kanë paraqitur për zhdoganim veturat. Gjatë javës së kaluar si dhe gjatë kësaj jave (26. 08. 2019 deri 04. 09. 2019) ka identifikuar tetë raste të veturave (që të gjitha janë penalizuar me rreth 5 000 euro gjoba), të cilat janë paraqitur për zhdoganim, ku pas verifikimit të kilometrave janë identifikuar se kemi të bëjmë me mashtrim në kilometra (kanë deklaruar më shumë kilometra sesa që realisht i ka vetura)", është thënë në njoftimin e Doganës. Sipas këtij njoftimi, Dogana e Kosovës do të

vazhdojë ta bëjë verifikimin e kilometrazheve të kaluara të veturave që do të zhdogohen. "Prandaj u bëjmë apel të gjithë qytetarëve, që mos të bien pre e personave të pandërgjegjshëm, të cilët mund edhe t'i ofrojnë ofertat për manipulime të kilometrazhit të veturës, me qëllim të shmangies nga detyrimet doganore sepse gjobat dhe taksat doganore prapë do t'i paguajë qytetari që e zhdoganon veturën. Dogana e Kosovës do ta vazhdojë drejt misionin e vet, zbatimin e ligjit në fushëveprimtarinë përkatëse", është thënë në këtë njoftim.



Kosova dhe Maqedonia nisin bashkëpunimin në fushën e regjistrimit të bizneseve



PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit në fushën e regjistrimit të bizneseve në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Me këtë rast, Nexhmije Selimi, drejtoreshë e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve (ARBK), ka thënë se qëllimi i këtij memorandumit është bashkëpunimi dhe zgjerimi i kapaciteteve në fushat përkatëse ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Ajo ka thënë se ARBK-ja është duke bërë hapa të mëdhenj në fushën e regjistrimit të biznesit. Më tutje, Selimi ka theksuar se me sistemin e ri elektronik të

gjitha bizneset janë duke u pajisur me numër unik identifikues. Ndërsa Maria Boshkovska-Jankofski, drejtoreshë e Regjistrimit Qendror në Maqedoninë e Veriut, ka vlerësuar lart memorandumin e nënshkruar, duke thënë se ky dokument ndihmon ARBK-në për listat e regjistrimit të bizneseve duke pasur parasysh se regjistri qendror është saktësia e të dhënëve për shërbimet e shpejta me praktikën më të mira. Po ashtu, ajo ka thënë se ky memorandum do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik ndërmjet dy vendeve.

Kosova, pjesë e marrëveshjes për bashkëpunim regional gjeohapësinor

PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Një delegacion i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i kryesuar nga kryeshëfi ekzekutiv, Avni Ahmeti, ka marrë pjesë në Konferencën e 12 regjionale për kadastër dhe infrastrukturë kombëtare për informacionet gjeohapësinore, e cila është mbajtur në Neum të Bosnje dhe Hercegovinës. Kjo agjenci ka bërë me dije se qëllimi kryesor i kësaj konference ka qenë nënshkrimi i marrëveshjes

së bashkëpunimit në mes të institucioneve përgjegjëse për hartografi dhe kadastër nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, respektivisht nga Republika e Kosovës, ajo e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina, Serbia, Sllovenia dhe Kroacia. "Kjo marrëveshje ka për qëllim ngritjen e shkallës së bashkëpunimit në mes të institucioneve respektive në fushat e

interesit të përbashkët, duke përfshirë avancimin e bashkëpunimit në kadastër, gjeodezi dhe hartografi, në zhvillimin dhe interoperabilitetin e GNSS sistemeve, në zhvillimin e rrjeteve gravimetrike dhe trigonometrike, në harmonizimin dhe hapjen e të dhënave hapësinore konform politikave dhe direktivave të BE-së e ngjashëm", është thënë në njoftimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Sipas këtij njoftimi,



kjo marrëveshje është përkrahur edhe nga shtete dhe organizata të fuqishme siç janë: qeveria suedeze, ajo norvegjeze, Qeveria

e Holandës, Banka Botërore, JICA, të cilat kanë qenë promotore të arritjes së kësaj marrëveshjeje.



Një delegacion i Universitetit të Cyrihut viziton institucionin parashkollor "Integj" në Gjilan

GJILAN, 6 SHTATOR (ER) - Një delegacion i Universitetit të Cyrihut, përkatësisht i Fakultetit të Edukimit, i kryesuar nga Nexhat Maloku, ka vizituar të premtën institucionin parashkollor "Integj" në Gjilan ku janë pritur nga drejtoresha e këtij institucioni, Drita Rexhepi-Hoxha. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë për të parë nga afër punën që bëhet aty nga stafi

me fëmijët e të gjitha grupmoshave, sikurse edhe për shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre. Drejtoresha e "Integj"-it, Drita Rexhepi-Hoxha, e ka falënderuar delegacionin nga Fakulteti i Edukimit në Cyrih për vizitën, duke thënë se kjo është një mundësi e jashtëzakonshme për të shkëmbyer përvoja mes vete për performancë sa më të mirë. Ndërsa delegacioni

nga Zvicra, i përbërë prej 15 studentëve dhe profesorëve, është ndarë i kënaqur me punën që bëhet në këtë institucion parashkollor, duke konfirmuar vizitën edhe në vitin e ardhshëm. Kjo është hera e katërt radhazi që disa studentë dhe profesorë të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Cyrihut vizitojnë këtë institucion parashkollor.

ASK-ja: Pagat në Kosovë nga viti 2012 janë rritur për 29.6 për qind

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka bërë me dije se nga viti 2012 pagat në vendin tonë janë rritur për 29.6 për qind. "Në vitin 2012 pagat mesatare bruto në Kosovë ishin 431 euro, kurse në vitin 2018 ishin 558 euro, një rritje prej 127 eurosh ose 29.6 për qind. Ndërsa paga neto nga 384 euro sa ishte në vitin 2012 është rritur në 498 euro në vitin 2018, apo me 114 euro më shumë, ose 29.8 për qind", është thënë në publikimin e ASK-së



PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportin për nivelin e pagave në Kosovë për periudhën 2012-2018. Ky publikim përmban të dhëna për pagën mesatare bruto dhe neto sipas sektorëve dhe aktiviteteve ekonomike në sektorin publik (administrata), sektorin privat dhe ndërmarrjet publike në Kosovë. Sipas këtij publikimi, në vitin 2012 pagat mesatare bruto në Kosovë kanë qenë 431 euro, kurse në vitin 2018 ishin 558 euro, një rritje prej 127 eurosh ose 29.6 për qind. Ndërsa paga neto nga 384 euro sa ishte në vitin 2012, është rritur në 498 euro në vitin 2018, apo 114 euro më shumë ose 29.8 për qind. Paga mesatare bruto në sektorin publik, sipas ASK-

së, në vitin 2012 ishte 407 euro, kurse në vitin 2018 ishte 573 euro, që shënon një rritje për 166 euro ose 40.8 për qind. Kurse paga mesatare neto nga 353 euro sa ishte në vitin 2012, është rritur në 509 euro, një rritje prej 156 eurosh ose 44.1 për qind.

Më tutje, ASK-ja ka bërë me dije se sektori privat në vitin 2012 kishte një pagë bruto mesatare prej 367 eurosh. "Sektori privat kishte një pagë bruto mesatare prej 367 eurosh në vitin 2012, ndërsa në vitin 2018 ishte rritur në 401 euro, një rritje prej 34 eurosh ose 9.3 për qind. Derisa paga neto nga 333 euro, sa ishte në vitin 2012, është rritur në 364 euro, një rritje prej 31 eurosh, ose 9.3 për qind", është thënë në publikimin e ASK-së. Ndërsa sa

iu përket ndërmarrjeve publike, ASK-ja ka bërë me dije se pagat janë rritur për 181 euro. "Paga mesatare bruto në sektorin e ndërmarrjeve publike në vitin 2012 ishte 518 euro, derisa në vitin 2018 ishte 699 euro, që është një rritje prej 181 eurosh ose 34.9 për qind. Ndërkaq, paga neto nga 465 euro sa ishte në vitin 2012, u rrit në 620 euro në vitin 2018, një rritje prej 155 eurosh ose 33.3 për qind", është thënë në këtë publikim.

Sipas këtij publikimi, niveli i pagave më të larta në Kosovë gjatë vitit 2012-2018 ka qenë te sektori i ndërmarrjeve publike, derisa paga më e ulët ishte në sektorin privat. "Paga mesatare bruto në vitin 2018, sipas aktiviteteve ekonomike, më e lartë ishte te: furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (843 euro); informimi dhe komunikimi (717 euro); shërbimet dhe tregëtimet (639 euro), derisa paga më e ulët

ishte te bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (256 euro). Paga mesatare neto në vitin 2018, sipas aktiviteteve ekonomike, ka të njëjtën renditje: furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (743 euro); informimi dhe komunikimi (635 euro); shërbimet dhe tregëtimet (569 euro), derisa paga më e ulët ishte te bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (237 euro)", është thënë raportin e publikuar nga ASK-ja.

KEDS-i pranon mirënjohje nga bizneset e Gremës në Ferizajt

PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Kompania Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) ka pranuar të premten mirënjohje nga bizneset për përkrahjen dhe investimet në Greme të Ferizajit. Me këtë rast, drejtori ekzekutiv i KEDS-it, Alper Erbas, është pritur në takim nga përfaqësuesit e bizneseve dhe atyre të Shoqatës së Përpunuesve të Drurit në Greme. Gjatë këtij takimi bizneset kanë shprehur falënderimet e tyre të shumta për investimet që KEDS-i ka implementuar në Greme, investime këto që janë një nga faktorët që kanë ndikuar në zhvillimin e këtyre bizneseve.

Gjatë këtij takimi Erbasi dhe përfaqësuesit e bizneseve kanë diskutuar edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me energjinë elektrike, respektivisht nivelin e investimeve të bërë nga KEDS-i, sukseset e kompanisë, sfidat dhe vështirësitë e tjera. Erbasi është zotuar që kjo përkrahje do të vazhdojë edhe më tutje për bizneset ferizajase. "KEDS-i që nga fillimi i operimit si kompani u ka kushtuar kujdes të veçantë bizneseve. Kompania ka punuar shumë gjatë këtyre viteve për të pasur furnizim stabil dhe kualitativ për të gjithë konsumatorët, e në veçanti për bizneset. Falë këtyre



investimeve sot konsumatorët biznesorë kanë furnizim më të mirë sesa që kishin para 6

vjetësh. Sot jemi të lumtur që me këtë mirënjohje edhe një herë po konfirmohet përkushtimi

ynë, përkrahja dhe bashkëpunimi në mes të KEDS-it dhe bizneseve. Por, ne nuk do të ndalemi me kaq. Takime dhe vizita do të ketë në vazhdimësi në tërë territorin e Kosovës, për të dëgjuar dhe parë nga afër nevojat e bizneseve për furnizim stabil me energji elektrike", ka thënë Erbas. Ndërsa Arben Rexhepi nga kompania "Loni Glass", njëherësh përfaqësues i Shoqatës së Përpunuesve të Drurit në Greme, në emër të bizneseve ka falënderuar KEDS-in për investimet në këtë zonë që, sipas tij, kanë ndikuar në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike.

KEK-u bën përgatitjet për sezonin dimëror

PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar opinionin e gjerë publik se remonset kapitale që kanë filluar qysh në mars të këtij viti në blloqet e "TC-A" dhe "TC-B" janë në përfundim e sipër. Kjo korporatë ka thënë se një gjë e tillë ka ndodhur falë punës kolosale që është bërë, në mënyrë që gjatë sezonit dimëror të jenë në funksion të gjitha

blloqet e prodhimit të energjisë elektrike. "Në këtë vazhde na lejoni t'ju njoftojmë se fillimi i procedurave për kthimin në punë të një njësie në "TC-A" është planifikuar të bëhet sot më 6 shtator 2019 gjatë ndërrimit të dytë. Gjatë kësaj kohe KEK-u nuk ka alternativë tjetër përveç startimit të njësive me naftë (derisa të arrihet temperatura e nevojshme në kazan) dhe, si rrjed-

him, për disa orë shkarkimi i pluhurit nga kjo njësi do të jetë më i theksuar. Me këtë rast, KEK-u me kohë ka njoftuar të gjitha institucionet relevante (komunën, MMPH-në, Policinë e Kosovës) duke kërkuar mirëkuptimin e tyre dhe të gjithë qytetarëve, me qëllim të ofrimit të stabilitetit energjetik edhe gjatë sezonit dimëror", është thënë në njoftimin e KEK-ut.



Komuna e Prishtinës: S' bëjmë kompromis me sigurinë e nxënësve të Gjimnazit 'Ahmet Gashi'

PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Komuna e Prishtinës, pas raportimeve të medieve për ngjarjet lidhur me Gjimnazin "Ahmet Gashi", ka njoftuar opinionin publik për të gjitha veprimet që janë marrë nga ana e kësaj komune lidhur me këtë temë. Kjo komunë ka theksuar se vendimi për dislokimin e përkohshëm të nxënësve nga kjo shkollë është marrë në muajin qershor, mbi raportin e vlerësimit të stabilitetit të ndërtesës, i cili tregon se objekti nuk i plotëson kushtet teknike, statike dhe seizmike për vazhdimin e mësimin aty dhe se paraqet rrezik potencial për shembje, marrë parasysh se ka dëmtime të thella në shtyllat mbajtëse dhe themelet e shkollës. "Paraprakisht është organizuar takimi me tre drejtorët e shkollave 'Ahmet Gashi', 'Emin Duraku' e 'Sami Frashëri' në mënyrë që të krijohen dhe koordinohen kushtet për punë pa pengesa, për nxënësit dhe mësimdhënësit. Në atë takim, të

gjithë janë pajtuar që dislokimi i nxënësve të fillojë më 2 shtator 2019. Në mbledhjen e Këshillit Drejtues të shkollës, më 17 korrik, është diskutuar vendimi i komunës për dislokim dhe informata është përcjellë te të gjithë pjesëmarrësit", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Sipas këtij njoftimi, përkundër pretendimeve se askush nuk është takuar me protestuesit, të enjten, pas protestës para ndërtesës së Komunës së Prishtinës, kryetari Shpend Ahmeti bashkë me drejtoreshën e Arsimit, Shpresa Shala, kanë takuar edhe përfaqësuesit e nxënësve, mësimdhënësit dhe drejtorin e Gjimnazit "Ahmet Gashi". "Në takim është diskutuar dhe sqaruar situata e krijuar. Po ashtu, u pajtuar se do të bëhet rivlerësimi i stabilitetit të objektit, i cili do të ndihmojë të vendoset nëse objekti ka nevojë për renovim të tërësishëm apo rindërtim nga e para. Për më tepër, drejtoresha e Arsimit,



Shpresa Shala, mbajti konferencë para të gjitha medieve, të cilat, për fat të keq, nuk arritën të raportojnë dhe informojnë

drejt dhe qartë këtë temë, duke i dhënë një kahe krejtësisht të gabueshme në publik. Përfundimisht, zhvendosja e

nxënësve bëhet menjëherë. Nuk bëjmë kompromis me sigurinë e jetës së fëmijëve tanë!", ka njoftuar kjo komunë.



Përkujtohet dëshmori Ilir Merturi

KLINË, 6 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë, qytetarë, ish-bashkëluftëtarë, miq dhe familjarë të dëshmorit të kombit Ilir Merturi, kanë bërë homazhe te varri i

tij në Kompleksin Memorial "Kodra e Kuqe" në Grabanicë. Ilir Merturi ka lindur më 6 shtator 1970 në Gjurgjevik të Madh, ndërsa ka rënë heroikisht më 29 janar të vitit 1999 duke luftuar kundër forcave okupuese serbe.

Misioni i EULEX-it e ndihmon me pajisje Shkollën Fillore 'Arif Shala'

DRENAS, 6 SHTATOR (ER) - Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) ka dhuruar pajisje shkollore për Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Arif Shala" në Korroticë të Ulët të Drenasit. Vlera e pajisjeve është mbi 10 mijë euro dhe përfshinë 10 llaptop, 5 "pc work", 12 makina fotokopjuese, 10 tabela "white board

magnetike", material për zyrë dhe inventar të nevojshëm për lehtësimin e procesit mësimor. Drejtori i kësaj shkolle, Murtez Shala, ka falënderuar misionin e EULEX-it për dhurimin e këtyre pajisjeve, duke shtuar se këto mjete do t'i ndihmojnë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.



Do të asfaltohen të gjitha rrugët e fshatit Lumbardhë të Deçanit

DEÇAN, 6 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, së bashku me nënkryetarin Sami Cacaj, ekzekutivin komunal, banorë të fshatit

Lumbardhë dhe përfaqësues të kompanisë kontraktuese, kanë marrë pjesë në nisjen e punimeve për rregullimin e të gjitha rrugëve të këtij fshati. Ramosaj ka bërë me

dije se brenda pak ditëve fshati Lumbardhë nuk do të ketë asnjë rrugë të paasfaltuar sepse, sipas tij, në këtë lokalitet është përfunduar edhe kanalizimi i ujërave të

zeza. Këto rrugë në gjatësi mbi 1.5 kilometra janë investim i Komunës së Deçanit dhe Ministrisë së Infrastrukturës, si dhe janë të përfshira në "LOTIN 2".



Miqtë interesohen për ne aq sa ne punojmë për veten

Kosova duhet të distancohet nga e kaluara e atyre politikanëve të cilët me veprimet e veta të papërgjegjshme ndikuan në zbehjen e interesimit ndërkombëtar ndaj nesh. Ky shans po ringjallet sërish dhe duhet të demonstrohet më 6 tetor



Shkruan: Mehmet PRISHTINA

Ata që bëjnë politikë lokale në Prishtinë harrojnë se mënyra se si i menaxhojnë institucionet vendore ndikon drejtpërdrejt në disponimin e aleatëve tanë për të vazhduar apo jo mbështetjen qoftë financiare, qoftë teknike, diplomatike etj. ndaj nesh. Gati shumë pak media dhe vëzhgues në Kosovë janë marrë profesionalisht me këtë temë dhe fare pak kush po i analizon shkaqet e

zbehjes së interesimit ndërkombëtar për forcimin e institucioneve të sigurisë, përfshirë Ministrinë e Brendshme, Forcën e Sigurisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Drejtësisë, por edhe të resurseve të tjera shtetndërtuese. Administrata e presidentit Trump ka reduktuar disa fonde që janë të dedikuara për Kosovën, e ku kryesisht janë programe për mbështetjen e institucioneve të sigurisë dhe ligjzbatimit, kurse një ndër arsyt kryesore lidhet me jo profesionalizmin e shfaqur në institucione të caktuara, si dhe me defokusimin e politikës vendore ndaj këtyre çështjeve jetike, ku gjithsesi janë edhe skandalet e shumta korruptive e nepotiste, pa harruar edhe punësime e profileve joadekuate e joprofesionale ku zakonisht dominojnë interesat e ngushta partiake.

Kjo zbehje interesimit ndërkombëtarë nuk lidhet gjithmonë me ndryshimin e strategjive të aleatëve tanë, sidomos SHBA ndaj rajonit dhe Kosovës në veçanti, por para së gjithash lidhet me bilancin e politikave publike që drejtojnë udhëheqësit politik e institucional në Prishtinë. Madje mund të thuhet se strategjia amerikane ndaj Kosovës është më konzistente se vet qëndrimi që kanë politikanët tanë ndaj çështjeve jetike që lidhen me ardhmërinë e vendit. Ata që bëjnë politikë lokale në Prishtinë, mendojnë se gjithë bota sillet rreth tyre, por harrojnë se bota ka shumë problem sot. Kanë kaluar 20 vite, prej atëherë kur Kosova ishte në qendër të fokusimit ndërkombëtar dhe falë ndikimit të fuqishëm amerikan ndodhi kthesa e madhe në vitin 1999. Por ajo që do të duhej të thuhet guximshëm nga intelektualët dhe mendimtarët e pavarur të Kosovës, ka të bëjë me keqpërdorimin e kësaj mbështetje ndërkombëtare nga ana e strukturave të caktuara politike të Prishtinës, përmes veprimeve aspak serioze, që jo rrallë binin ndesh me interesat strategjike të aleatëve tanë. Këto struktura kishin harruar se aleancat nuk janë të përjetshme dhe se mund të ndodhë që

armiqtë e shtetit të Kosovës ta shfrytëzojnë këtë joseriozitet të Prishtinës zyrtare duke kthyer në favor të tyre simpatitë e shteteve Perëndimore, përmes politikave të hapura dhe propagandave agresive, por edhe përmes lobimeve e veprimeve jotransparente, ku bëjnë pjesë edhe martesat me zyrtarë ndërkombëtarë, të cilët në raste të caktuara mund të jenë edhe subjektiv në vendimmarrjet e tyre. Kosova nuk ka një strategji kombëtare për parandalimin e devijimeve të ndryshme. Në mungesë të kësaj strategjie ndodhi që vendi ynë të bëhet rekrutues i luftëtarëve të luftërave të huaja, kurse institucionet shtetërore e fetare u treguan të pafuqishme në parandalimin e kësaj dukurie që ishte e orientuar drejtpërdrejt kundër interesave tona gjeostrategjike dhe orientimit tonë civilizues. Pjesëmarrja e dhjetëra kosovarëve të rinj në frontet e ISIS-it ishte një lajm i keq për miqtë tanë amerikanë, sepse këta të fundit ishin frontmenët globalë të luftës kundër radikalizmit islamik. Ndonëse raste të izoluar dhe me një intensitet të zvogëluar kohëve të fundit, kjo pjesëmarrje e kosovarëve në frontet e luftërave të huaja në Siri e Irak, burimin e ka në keqmenaxhimin

institucional të pakënaqësive sociale nga ana e atyre që e udhëhoqën shtetin e Kosovës, me shpresë që kështu nuk do të jetë pas zgjedhjeve parlamentare të tetorit. Kur jemi te zgjedhjet, Qeveria që do të merr drejtimin e vendit, punën e parë që do të duhej ta bënte do të ishte rikthimi i besimit të miqve tanë ndërkombëtarë, duke i bindur ata se shteti ynë ka ende nevojë për ndihmën e tyre, kurse në shenjë mirënjohjeje për këtë ndihmë do të duhej të ngritët në nivele maksimale niveli i përgjegjesisë institucionale, që nënkupton edhe hapja e një fronti të madh kundër të gjithë atyre që do të guxonin ta keqpërdorin shtetin, parandë publike, resurset qeveritare për përfitime personale. Vetëm në këtë mënyrë mund të dëshmojmë në praktikë se e meritojmë përkrahjen amerikane dhe evropiane, sepse edhe një mik nëse të ndihmon, ai është i interesuar të dijë nëse ndihma e tij ka pasur apo jo efekt. Kosova duhet të distancohet nga e kaluara e atyre politikanëve të cilët me veprimet e tyre të papërgjegjshme ndikuan në zbehjen e interesimit ndërkombëtar ndaj nesh. Ky shans po ringjallet sërish dhe ajo duhet të demonstrohet më 6 tetor.

Funksionalizohen semaforët në qytetin e Mitrovicës



MITROVICË, 6 SHTATOR (ER) - Në kuadër të prioritetëve për përmirësimin e jetës së qytetarëve, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë ka përfunduar implementimin e projektit për vendosjen e semaforëve në qytetin e Mitrovicës. Semaforët janë vendosur në tri pikat më kryesore të qytetit tek ish-hotel "Adriatiku", vendkalimi i hekurudhës (ruga "Shemsi Ahmeti") dhe stacioni i autobusëve. Me këtë rast, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, gjatë inspektimit të punimeve ka thënë se ky projekt është tejet i rëndësishëm, pasi do të mundësojë një qarkullim më të mirë të automjeteve dhe

qytetarëve në qytet. "Janë tri pika në fillim dhe në të ardhmen besoj se do të vendosen edhe në pika të tjera, sipas nevojës", ka thënë drejtori Muja. Ai ka bërë apel që Policia e Kosovës të ndërmarrë aksion për largimin e automjeteve të cilat parkohen afër semaforëve dhe pengojnë komunikacionin. Ndërsa qytetarët mitrovicas e kanë mirëpritur realizimin e këtij projekti duke e konsideruar të domosdoshëm për qytetin e Mitrovicës, në të njëjtën kohë kanë falënderuar drejtorin Muja për angazhimin e palodhshëm për krijimin e kushteve dhe sigurimin e një jete dhe mirëqenie më të mirë për qytetarët.

Komuna e Prizrenit mbulon shpenzimet e varrimit

PRIZREN, 6 SHTATOR (ER) - Komuna e Prizrenit tani e tutje do ta bëjë mbulimin e të gjitha shpenzimeve të varrimit dhe në bashkëpunim me bashkësitë fetare dhe kompaninë rajonale "Ekoregioni" do t'i ofrojë edhe

shërbimet e varrimit për të gjithë banorët e kësaj komune. Lajmin e kanë bërë me dije në një konferencë për medie drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Levent Kasemi dhe ai i Drejtorisë së Punës dhe

Mirëqenies Sociale, Fejzë Kabashi. Ata kanë thënë se e gjitha që duhet të bëhet nga familjarët është që në momentin kur ka rast vdekje të jepet njoftimi në numrin e telefonit +383 49 305 050 për ta treguar adresën dhe

kohën se kur duhet të bëhet varrimi i të ndjerit. Përveç kësaj, Komuna e Prizrenit ka nënshkruar marrëveshje me "Ekoregionin" edhe për mirëmbajtjen e të gjitha varrezave në territorin e Komunës së Prizrenit.



Merkeli pritët me nderime në vizitën e 12-të në Pekin

PEKIN, 6 SHTATOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel u prit me nderime të mëdha në Pekin nga kryeministri Li Keqiang në fillimin e një vizite dyditore që zhvillohet në kohën kur marrëdhëniet e Gjermanisë me Kinën janë më komplekse se kurrë, dhe lista e temave të parehatshme, mjaft e gjatë.

E shoqëruar nga një grup liderësh gjermanë të biznesit, kancelarja udhëtoi për të 12-ën herë drejt këtij vendi që kur mori postin nëntorin e vitit 2005.

Media shtetërore kineze e trumbetoi vizitën e saj si një shans të

mirë për t'i forcuar marrëdhëniet dypalëshe. Xinhua madje shkruante se "ekziston një nevojë urgjente që Gjermania dhe Kina të mbrojnë një ekonomi të hapur globale". Pritet që Merkel gjatë kësaj ndalesë të takohet dhe me presidentin Xi Jinping. Kina është një prej partnerëve më të mëdhenj tregtarë të Gjermanisë, dhe në 2017-ën ka blerë gati 100 miliardë dollarë të eksporteve gjermane.

Por ajo është gjithashtu edhe një konkurrente e fortë për sa i takon tregtisë. Sipas ekono-

mistëve, Gjermania ndodhet në fillim të një recesioni, dhe pikërisht frika e një rënieje ekonomike mund t'i nxisë përpjekjet e Berlinit për marrëdhënie më të mira tregtare me Pekinin. Përpos një takimi të mundshëm me Jinping, nuk ka ndonjë informacion tjetër të detajuar mbi axhendën e Merkelit përpara se të largohet sot (e Shtunë). Por pritët të shihet nëse do të preket çështja e të drejtave të njeriut në vend, bisedimet mbi të cilat po bëhen më të rralla e më të vështira. (tch).



Pronat e presidentit Trump dhe konflikti i interesit

Një vendpushim golfi me pesë yje në Irlandë, pronë e presidentit Trump, është vënë në vëmendjen e medias, pas një vizite zyrtare të zëvendëspresidentit Mike Pence këtë muaj

WASHINGTON, 6 SHTATOR - Administrata Trump është vënë në vëmendjen e medias pas njoftimit se zëvendëspresidenti Mike Pence kishte qëndruar në një hotel të presidentit Trump gjatë një vizite zyrtare që bëri në Irlandë. Kjo vjen pas sugjerimit të presidentit që vendpushimi i tij në Majami të Floridës të shërbejë si vend për takimin e nivelit të lartë të shtatështes vitin e ardhshëm. Trumpi po i kundërvihet traditës presidenciale për të mos përzier biznesin personal me punët e qeverisjes. Një vendpushim golfi me pesë yje në Irlandë është vënë në vëmendjen e medias, pas një vizite zyrtare të zëvendëspresidentit Mike Pence këtë muaj. "Qëndrimi në resortin Trump National në Doonbeg, për të akomoduar shpenzimet e personelit të sigurisë dhe të personelit tjetër, ishte diçka logjike", thotë Pence. Kritikët ngrenë pikëpyetje se përse duheshin përdorur paratë e taksapaguesve për të qëndruar në një hotel 300 kilometra larg nga kryeqyteti Dublin, ku Pence zhvilloi takimet e tij zyrtare.

Jeremy Venook, është analist i Qendrës për Progresin Amerikan, një organizatë me prirje të majta. "Kjo javë që kaloi ka qenë vërtet një rast tipik që flet për një presidencë që reklamonte mallin e vet", thotë analisti.

Shefi i stafit të Pence tha se ishte presidenti Trump që i kishte sugjeruar nënpresidentit të qëndronte në hotelin e tij.

Presidenti Trump e mohon këtë. "Nuk ishte ideja ime që Mike të qëndronte atje. Ai shkoj atje sepse familja e tij ishte atje", tha ai.

Si mikpritës për samitin e ardhshëm të G7-s, presidenti Trump tha në muajin gusht se po shikon mundësinë që resorti i tij në Majami të bëhet vendi pritës për takimin e vitit 2020. "Ne kemi një seri vilash madhështore. Secila prej tyre mban nga 50 deri në 70 veta, kanë dhoma shumë luksoze me pamje të mrekullueshme. Kemi salla të jashtëzakonshme konferencash, restorante të jashtëzakonshme, pra është diçka logjike", tha ai. Presidentët zakonisht përpiqen të shmangin qoftë edhe perceptimin e konfliktit të interesit,



duke iu përmbajtur një klauzole të rreptë kushtetuese për antikorruptsionin. "Klauzola e ndalon presidentin nga çdo lloj përfitimi material që vjen si pasojë e vendimeve të marra prej tij në funksionin si president", tha Todd Belt, profesor i politikës në Universitetin George Washington.

Disa analistë thonë se Trumpi është ndryshe nga të tjerët. "Trumpi duket mjaft i interesuar jo vetëm që të reklamojë pasurinë e tij, por edhe që njerëzit të kuptojnë se ai dëshiron t'i reklamojë pronat e tij", tha Vanessa Beasley, studiuese e presidencës në Universitetin Vanderbilt.

Për dallim nga paraardhësit e tij, presidenti Trump nuk pranoi të

heqë dorë nga bizneset e tij pas marrjes së detyrës, gjë për të cilën kritikët thonë se i hap derën konflikteve të interesit. "Prokurori i përgjithshëm Bill Barr organizon takime në Hotelin Trump, senatorë, njerëz të Kongresit si dhe qeveritarë mbajnë po ashtu konferenca në pronat e Trumpit. Është mjaft e vështirë të mos e shohësh këtë si një përpjekje të koordinuar për të kënaqur presidentin Trump duke reklamuar bizneset e tij", thotë Venook.

Presidenti mohon se ka ndonjë motiv politik. "Unë kam shumë hotele në të gjithë vendin dhe njerëzit i përdorin ato sepse janë më të mirët. Dua të them, ju e dini, ato janë më të mirët!", tha ai. Ai, gjithashtu, shpesh nënvizon se sa para po humbet duke qenë

president, në vend që t'i drejtojë bizneset e tij - një mesazh që disa studiues thonë se mund të ketë efekt tek baza e tij politike. "A nuk është kjo në fakt arsyeja se pse disa njerëz e zgjedhën atë? Pra sepse menduan se aftësia e tij për biznes ishte aq e mirë sa kjo do të ishte diçka e mirë për vendin?", thotë Beasley.

Në muajin korrik presidenti Trump fitoi një çështje gjyqësore të ngritur kundër pronës së tij, një hotel që ndodhet shumë pranë Shtëpisë së Bardhë. Gjykata hodhi poshtë pretendimin se presidenti ka shkelur Kushtetutën duke mbledhur fitime nga zyrtarë të huaj të cilët kanë qëndruar në hotelin e tij gjatë vizitës në kryeqytetin e vendit.

Opozita në Britani i kundërshton zgjedhjet e parakohshme

LONDËR, 6 SHTATOR - Partitë opozitare në Britaninë e Madhe u pajtuan që të mos e mbështesin kërkesën e kryeministrit Boris Johnson për zgjedhje të përgjithshme përpara një samiti të Bashkimit Evropian, në mes të tetorit.

Opozita, me në krye dy partitë më të mëdha: Laburisët dhe Demokratët Liberalë, tha se do të votojë kundër qeverisë ose do të abstenojë në votimin e së hënës për mbajtjen ose jo të zgjedhjeve të

parakohshme.

Johnsoni tha se partitë po bëjnë një "gabim të jashtëzakonshëm politik". Ai do që zgjedhjet të zhvillohen më 15 tetor, përpara samitit në Bruksel më 17 dhe 18 tetor. Sipas tij, një gjë e tillë do t'i mundësonte qeverisë të realizojë Brexit-in, apo daljen e Britanisë nga BE-ja, më 31 tetor.

Data e Brexit-it është shtyrë dy herë. Johnsoni këmbëngul se procesi duhet të realizohet në fund të mua-

jit të ardhshëm, me ose pa marrëveshje me BE-në.

Por, një gjë e tillë kundërshtohet nga shumica e deputetëve në Parlamentin britanik, të cilët kanë miratuar një projektligj që e parandalon largimin e Britanisë pa marrëveshje.

Brexit-i pa marrëveshje do të nënkuptonte pasojat e rënda ekonomike për Britaninë, ka paralajmëruar Fondi Monetar Ndërkombëtar.



Ndërron jetë këngëtarja e njohur



Kylie Rae Harris, këngëtarja amerikane ka ndërruar jetë nga një aksident automobilistik të mërkurën në New Mexico. Lajmin e ka bërë me dije Alex Torrez, drejtori i kompanisë që menaxhonte

këngëtarën. "Ne jemi të zemëruar për të konfirmuar se Kylie Rae Harris ndërroi jetë në një aksident automobilistik natën e kaluar", është thënë Torrezi nëpërmjet një deklarate.



Demi si asnjëherë më parë "habit" fansat e saj

Ka shumë personazhe të njohura që edhe pse nuk janë perfekte e duan veten e tyre dhe nuk kanë komplekse. Një nga ato është edhe Demi Lovato. Këngëtarja amerikane, nuk heziton të ekspozohet edhe pse nuk ka një trup perfekt. Ajo ka publikuar disa

foto në llogarinë e vet në "Instagram" nga pushimet në Bora Bora, ku shfaqet me një palë bikini leopard dhe pa u ndjerë keq ka vënë të pasmet e saj. Gjithashtu ajo tregon se në të vërtetë u desh shumë kohë që të postonte foton pa e rregulluar.

Irina Shayk pjesë e kampanjës së "Calvin Klein"



Supermodeluesja, Irina Shayk, konsiderohet si njëra nga gratë më të bukura në botë. Shayk është bërë pjesë e kampanjës më të re të

"Calvin Klein". Shayk është duke promovuar çantat më të reja të kësaj kompanie. Ajo ishte e zhveshur në videon e reklamës dhe dukej shumë seksi.

Nicki Minaj, tërhiqet nga muzika



Nicki Minaj ka thënë se ka vendosur që të tërhiqet nga muzika dhe t'i përkushtohet familjes. Lajmin e ka bërë me dije vetë ylli i muzikës, e cila u ka thënë fansave që i do shumë. E nominuara për çmimin "Grammy" është duke takuar me Kenneth Petty dhe ka lënë

të kuptohet se ata po planifikojnë të martohen. Përveç muzikës, 36-vjeçarja është shfaqur në disa filma në "Hollywood" dhe ka një emision të saj në radio. Ajo nuk e ka bërë të qartë se sa prej ndërmarrjeve të saja po tërhiqet edhe nëse është serioze në atë që ka shkruar.

E rrallë

Njihuni me fshatin përrallor ku makinat nuk ekzistojnë

Duket si një përrallë e vërtetë! Gietorn është fshati, që do të donte ta vizitonte të paktën një herë në jetë çdo njeri. Kjo për faktin se në këtë fshat nuk lejohen makinat dhe brenda tij duhet të përdorësh vetëm mjete lundruese. Fshati ndodhet në provincën holandeze të Overijselit, ndërsa ka shtëpi, hotele, muze dhe restorante. Fshati i ndërtuar me bukuri përralore ka marrë jo më kot nofken



"Venecia Holandeze". Përveçse në verë, kur gjelbërimi e bën çdo gjë më të bukur, fshati tërheq turistë edhe në dimër, pasi kanalet ngrihen nga i ftohti dhe bëhen vende ideale për patinazh.

FOTO E DITES



Pamjet nga ajri tregojnë dëmtimet e shkaktuara nga uragani "Dorian", i cili ka goditur ishullin "Great Abaco" në Bahama /AFP/

E jashtëzakonshme

Gjykata franceze shpall të pafajshëm gjelin, ai mund të këndojë sa të dojë

Një gjykatë në Francë ka marrë vendim që gjeli Maurice mund të vazhdojë të këndojë, duke hedhur poshtë ankesën e komisionit, i cili akuzoi pronaren e tij për shkak të zhurmës. Pronarja e Maurice, Korin Feso, mund të mbajë gjelin në ishullin e vogël Oleron të Francës. Kohë më parë gjeli Maurice ishte bërë kryelajm



nëpër media, ku ishte ngritur çështja nëse mund të këndojë

çdo mëngjes në ishullin Oleron. Pronarja e që jeton në ishullin Oleron prej 35 vjetësh, kishte thënë se ajo është detyruar ta mbyllë brenda shpendin e saj gjatë natës dhe të mbulojë strehën e tij me kartonë, në mënyrë që të bllokojë dritën dhe ai të mos këndojë, por nuk ka pasur sukses.

BARSOLETA E DITËS



E dashura: Zemër a shkojmë në restorant sonte?
I dashuri: Po, por vetëm tregoma arsyen?
E dashura: Për darkë! A nuk po të pihet asgjë?
I dashuri: Me të thënë të drejtën dora është ka me pihet!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30

ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

<p>DASHI Lidhja e dashurisë mund të pësojë një krizë. Motoja juaj sot duhet të jetë: "Nëse nuk ke diçka të mirë për të thënë, mos fol fare". Kjo mund të ta "lidhë" gjuhën, por kjo është zgjidhja.</p>	<p>DEMI Ju mund të kujdeseni për të tjerët më shumë se për veten. Mos sakrifikoni veten për të ndihmuar të tjerët. Ndër të tjera, është e rëndësishme të mos mendoni vetëm për veten.</p>	<p>BINJAKËT Jini të disiplinuar. Ruani distancën dhe mos bëni thashetheme për të tjerët. Mund të jetë kënaqësi t'i shmangeni problemeve duke hyrë në jetën e dikujt tjetër, por se shpejt do të kuptoni se kjo nuk zgjidh asgjë.</p>	<p>GAFORRJA Mund të thoni aq shumë gjëra gjatë ditës, sa do t'i kujtoni në darkë e të pendoheni. Madje mund të ndiheni fajtorë. Mund ta parandaloni këtë nëse mendoni para se të flisni. Ju keni fuqinë të ndikoni tek të tjerët në një nivel emocional.</p>	<p>LUANI Njerëzit duan të komunikojnë me ju, por mund të mos e keni mendjen sepse e keni mendjen tek vështirësitë tuaja. Do të jeni shumë të shpërqendruar, prandaj ndaloni, mendoni dhe veproni.</p>	<p>VIJRGJËRËSHA Mund të ndjeni se nuk merrni vëmendjen që keni nevojë ose meritoni. Për këtë arsye, do t'i tërhiqni "veshin" personave që doni. Kjo gjë nuk do ju ndihmojë aspak sepse askush nuk do të jetë pranë dikujt që nuk ndihet i lumtur.</p>
<p>PESHORJA Përpikuni të mos largoni njerëzit që duan t'ju ndihmojnë. Nëse i tregoni të tjerëve problemet që keni, mund t'ju japin zgjidhje. Por mos harroni që lumturia është përgjegjësia juaj. Do të ndiheni mirë vetëm nëse kujdeseni për veten.</p>	<p>AKREPI Aftësitë e tua më të mira ju ndihmojnë që ti jepni zgjidhje situatave të paretshme. Po ka raste që nuk dini ti përdorni siç duhet. Nëse jeni në një punë të pakëndshme, është vetëm se keni frikë të guxonit për diçka të re.</p>	<p>SHIGJETARI Mund të ndiheni të vetmuar dhe të izoluar, sikur nuk keni askënd me që të flisni. Madje ju duket sikur flisni me veten gjithë kohës dhe askush nuk ju dëgjon. Në fakt, nuk ka asgjë që nuk shkon me ju apo të tjerët që ju rrethojnë.</p>	<p>BRICJAPI Mos u sillni si të dëshpëruar. Ju keni tendencën që të silleni në këtë mënyrë derisa dikush ta kuptojë dhe t'ju pyesë nëse ka diçka që nuk shkon. Nëse askush nuk e vë re, ju mund të zemëroheni dhe të ndiheni sikur nuk keni miq.</p>	<p>UJORI Ndiheni të frikësuar ose të trembur. Ndoshta kjo vjen sepse nuk mund të shprehni ashtu siç dëshironi. A ju bëjnë njerëzit të ndiheni kështu apo problemi qëndron tek ndjenjat tuaja?</p>	<p>PESHQIT Kini kujdes që të lini humorin e keq t'ju prishë ditën. Ndoshta nuk do të ndiheni të gëzuar dhe kjo mund të ketë një efekt dramatik te të gjithë të tjerët.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Challandesi: Na duhet një lojë e çmendur për fitore ndaj Çekisë

"Dardanët" e vazhdojnë rrugëtimin drejt kualifikimit në Kampionatin Evropian sot (e shtunë), kur përballen me Republikën Çeke. Kosovës në këtë ndeshje do t'i mungojnë Milot Rashica, Arbër Zeneli, Herolind Shala, Hekuran Kryeziu dhe Benjamin Kololli. Përzgjedhësi Bernard Challandes ka kërkuar një lojë të çmendur për t'i siguruar pikët e plota nga kjo ndeshje, kurse një gjë të tillë e ka kërkuar edhe mbrojtësi Mërgim Vojvoda



shkon kampiones aktuale të botës, Francës. Kapiteni i Shqipërisë, Elseid Hysaj, beson se shanset e ekipit kuqëzi përballë Francës për të nxjerrë rezultat pozitiv ekzistojnë. "Ne duam rezultat pozitiv. Nuk vijmë këtu për të humbur. Franca është Francë, por jam i sigurt se me këtë grup dhe me këtë trajner (Edy Reja) ne do t'i tregojmë vlerat tona. Ne shkojmë me idenë për të marrë pikë, një ose tri, me lojë të mirë dhe duke fituar terren. Sigurisht se do të përballemi me një ekip më të fortë, por Shqipëria mund të fitojë", ka thënë Hysaj.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të premtën e përfundoi stërvitjen e pestë dhe të fundit para ndeshjes kualifikuese për Kampionatin Evropian ndaj Çekisë, e cila zhvillohet sot (e shtunë) nga ora 15:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". Në konferencën për medie përzgjedhësi Bernard Challandes ka kërkuar që "Dardanët" të zhvillojnë një ndeshje të çmendur në mënyrë që të arrijnë fitore ndaj Republikës Çeke dhe në këtë rast t'i ruajnë shpresat për kualifikim në "Euro 2020".

Trajneri zviceran pati fjalë të mira për kundërshtarin e radhës, i cili ka dy fitore në ndeshjet kualifikuese. "Çekia i ka dy fitore dhe ka një ekip të fortë dhe për ne nuk do të jetë e lehtë. Duhet të bëjmë një lojë të çmendur sepse nuk mund të luajmë një lojë normale. Është një rast i mirë për ekipin që të luftoj dhe dua që të funksionojmë si ekip. Shpresoj ta kemi gati skuadrën për ndeshjen ndaj Çekisë. Kur flas për ndeshje të çmendur e kam për pasionin dhe vullnetin. E kam për të qenë gjithmonë i gatshëm për aksion. Është një mentalitet që gjithmonë kërkohet të jesh gati për të shënuar dhe për t'u mbrojtur në çdo çast. Gjithashtu, kërkojmë një mbështetje të çmendur edhe nga publiku pasi na duhet fitorja", ka thënë Challandes, duke mos pranuar ta zbulojë formacionin.

Trajneri nga Zvicra nuk e përjash-

toi mundësinë që në këtë ndeshje të jetë titullar Elbasan Rashani, i cili ka zhvilluar disa lojëra të mira. Krah përzgjedhësit në konferencë për medie ishte edhe futbollisti Mërgim Vojvoda. Mbrojtësi i djathtë i "dardanëve" ka thënë se Çekia është një skuadër e fortë, por se Kosova në çdo ndeshje hyn për fitore. "E dimë që kemi mungesa, por ekipi është përgatitur. Në çdo ndeshje duhet të futemi për t'i fituar tri pikë. Është e rëndësishme të shënojmë gol. Kemi treguar se luajmë shumë mirë dhe japim maksimumin. Çekia është ekip shumë i fortë, por jemi përgatitur dhe i kemi studiuar pikat e saj të dobëta. Ndërsa konkurrenca në skuadër është gjithmonë e mirë, pasi na shtyn ta japim maksimumin", ka thënë Vojvoda. Për ndeshjen e Grupit A që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë ka folur edhe kapiteni i Çekisë, Marek Suchy. Ky i fundit ka paralajmëruar se kanë ardhur në Kosovë për fitore. Megjithatë, Suchy ka pranuar se

"dardanët" kanë një skuadër cilësore dhe se duhet të jenë shumë të kujdesshëm në këtë ndeshje. "Presim ta zhvillojmë një lojë ashtu siç dëshirojmë dhe mos të ndikohemi nga asgjë. Secila lojë është shumë e rëndësishme. Ne kemi ardhur për fitore dhe duam fitore. Kosova e ka një sulm shumë cilësor dhe duhet të jemi të kujdesshëm pasi mund të na ndëshkojnë", ka thënë Suchy. Kosova renditet në pozitën e tretë me 5 pikë, kurse Çekia është e dyta me 6 pikë.

'Marca': Kosova, konkurrenca befasuese në 'Euro 2020'

E përditshmja spanjolle "Marca" e ka konsideruar befasues rrugëtimin e deritanishëm të Kosovës në kampanjën kualifikuese për Kampionatin Evropian 2020, pas fitores në Bullgari në qershor. Tani që kanë filluar ndeshjet e radhës të kombëtareve, të cilat në Evropë po përballen në kuadër të

kualifikimeve për "Euro 2020", "Marca" e ka publikuar një artikull të titulluar "Situata aktuale për kualifikim në 'Euro 2020'". Në mesin e grupeve të analizuara në këtë artikull është edhe Grupi A, ku garon edhe Kosova përballë Anglisë, Republikës Çeke, Bullgarisë dhe Malit të Zi. Kosova deri më tani i ka grumbulluar pesë pikë nga tri ndeshje të zhvilluara - dy barazime dhe një fitore - duke u radhitur e treta në Grupin A, me një pikë më pak se Anglia dhe Republika Çeke. "Anglia është duke e drejtuar grupin pas dy fitoreve bindëse nga dy ndeshjet hapëse. Kosova është bërë konkurrenca befasuese, pasi fitoi si mysafire kundër Bullgarisë në qershor", shkruan "Marca". "Ata do të udhëtojnë në Southampton për të luajtur kundër Anglisë të martën, pasi skuadra e Gareth Southgate do të përballlet fillimisht me Bullgarinë në 'Wembley' të shtunën". Edhe nëse nuk arrihet kualifikimi përmes Grupit A, Kosova do ta ketë një mundësi të dytë për t'u kualifikuar - përmes "play-off"-it të Ligës së Kombeve, ku në gjysmëfinale do të përballlet me Maqedoninë, ndërsa në finale mund ta ketë kundërshtarë Gjeorgjinë ose Bjellorusinë.

Sonte përballen Franca dhe Shqipëria

Kombëtarja e Shqipërisë do të ketë punë të vështirë në ndeshjen e pestë në kualifikueset për Kampionatin Evropian "Euro 2020", pasi sonte (e shtunë) i



GRUPI A		
15:00 Kosova - Çekia		
18:00 Anglia - Bullgaria		
TABELA		PIKË
1. Anglia	2	6
2. Çekia	3	6
3. Kosova	3	5
4. Mali i Zi	4	2
5. Bullgaria	4	2
GRUPI B		
18:00 Lituania - Ukraina		
20:45 Serbia - Portugalia		
TABELA		PIKË
1. Ukraina	4	10
2. Luksemburgu	4	4
3. Serbia	3	4
4. Portugalia	2	2
5. Lituania	3	1
GRUPI H		
18:00 Islanda - Moldavia		
20:45 Franca - Shqipëria		
20:45 Turqia - Andorra		
TABELA		PIKË
1. Franca	4	9
2. Turqia	4	9
3. Islanda	4	9
4. Shqipëria	4	6
5. Moldavia	4	3
6. Andorra	4	0

Besa kërkon sukses ndaj Winterthurit

PEJË, 6 SHTATOR - Klubi pejan Besa Famgas në Evropë luan nga viti 2005, ndërsa me suksese më të mëdha ka nisur nga viti 2013. Besa është përballur me skuadra të forta evropiane

gjatë viteve të kaluara, por suksesi nuk ka munguar. Një skuadër të fortë do ta ketë përballë edhe në fundjavë, atë nga Zvicra, Pfadi Winterthur. Ndeshjet në mes të Besa

Famgasit dhe Winterthurit luhen të shtunën e të dielën nga ora 19:00 në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Besa pret përkrahjen e tifozëve në tentim për të bërë hap para në gara

evropiane. Winterthuri është ekip cilësor, sikurse edhe kampioni i Kosovës. Në klubin pejan besojnë se me përkrahjen e tifozëve dhe me lojë me zemër suksesi është i mundshëm.



Gjilani sot udhëton drejt Zvicrës

GJILAN, 6 SHTATOR - Skuadra e Gjilanit të premtën e ka mbajtur seancën e fundit para nisjes së për në shtetin helevetik. Në këtë stërvitje ka punuar së bashku me skuadrën edhe Muhamet

Useini, i cili ka lënë prapa lëndimin në ndeshjen kundër Ferizajt, lëndim që e mbajti atë larg fushës për disa ditë. Vlen të ceket se mungesa e Ylli Shametit, i cili nuk do të udhëtojë me

skuadrën drejt Zvicrës, me ç'rast ai po rikuperohet nga një lëndim muskolor. Shameti pritet që para ndeshjes së javës së katërt kampionale, kundër Drenicës që t'i rikthehet punës me

skuadrën e Gjilanit. Ekspedita e Gjilanit nesër (e shtunë) do të udhëtojë drejt shtetit të Zvicrës, ku ditën e diel do të ndeshet me ekipin nga liga e dytë zvicerane, FC Schaffhausen.



Khaka: Shaqiri mund ta ketë shiritin e kapitenit



CYRËH, 6 SHTATOR - Shiriti i kapitenit është kthyer në një çështje problematike në kombëtaren zvicerane të futbollit, për më tepër me dy protagonistë shqiptarë. Mesfushori ofensiv i helvetikëve, Xherdan Shaqiri, refuzoi t'i përgjigjej thirrjes së përfaqësueses për sfidat e këtij muaji me Irlandën dhe Gjibraltarin, e duket se motivi është shiriti që ndodhet në

krahun e Granit Xhakës. "Nëse ky është me të vërtetë problemi, Shaqiri mund të ketë shiritin e kapitenit. Për mua nuk ka rëndësi nëse e kam shiritin e kapitenit apo jo. Mendohem të kem impakt tek ekipi me apo pa këtë shirit", shprehet kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka. Arsyeya zyrtare e bojkotit të Shaqirit ishte fokusi te Liverpooli, por kjo tezë ka rënë poshtë edhe për faktin se

mesfushori po konsiderohet shumë pak te kampionët e Evropës. Jo zyrtarisht, Shaqiri është i pakënaqur me konsideratën e trajnerit Petkovic dhe shiriti i kapitenit ishte ajo që solli dhe krisjen finale. Granit Xhaka konsiderohet një zgjatim në fushë i trajnerit të Zvicrës, ndërsa Shaqiri ka lirinë taktike, por nuk ka kontakt personal me teknikun.

Hamiltoni ia 'shkel' syrin Ferrarit

BERLIN, 6 SHTATOR - "Në Monza kam fituar disa herë, duke ua prishur festën tifozëve italianë të Ferrarit. Më pas ata më kanë kërkuar që një ditë ta pilotoj makinën italiane. Nuk e di nëse do ta realizoj ndonjëherë këtë gjë, por nëse largohem nga Mercedesi, opsioni i vetëm do të jetë Ferrari", u shpreh Lewis Hamiltoni.

Gjithsesi, piloti britanik pranon se vështirë se ai do të largohet nga makina gjermane. "Kur je pjesë e Mercedesit, kur je pjesë e kësaj familje për një kohë të gjatë, vështirë të largohesh kur sheh rezultatet pozitive", ka deklaruar Hamiltoni. "Te Ferrari janë dy pilotë të mëdhenj, Vettel e njohim të gjithë, ndërsa Leclerc e ka më të lehtë tani që fitoi një herë. Madje për të do të jetë më e lehtë. Unë do ta bëj maksimumin për të fituar, edhe pse kjo është një pistë që favorizon Ferrarin. Koha mund t'i bëjë gjërat e thjeshta më të vështira, ndaj të shohim", ka shtuar Hamiltoni.



SHKURT

Kosova U16 barazon ndaj Luksemburgut

Përfaqësuesja U16 e Kosovës në futboll ka barazuar 3-3 në miqësoren e radhës kundër Luksemburgut. Ndryshe nga ndeshja e parë e zhvilluar tri ditë më parë në të cilën Kosova fitoi 2-0, kësaj radhe loja ishte më e baraspeshuar. Për "Dardanët" e rinj golat i shënuan Adonis Morina dhe Florian Berisha, kurse golin e tretë ia dhuroi një nga futbollistët luksemburgas i cili realizoi autogol.

Josa, afër Shkëndijës

Pasi u shkarkua nga drejtimi i Prishtinës, Mirel Josa përflitet sërish pranë një klubi shqiptar, këtë herë në Maqedoninë e Veriut. Është "Gazeta Lajm", e cila shkruan se Shkëndija e Tetovës po mendon të marrë në krye të ekipit pikërisht Josën. Vetë tetovarët javën e kaluar shkarkuan trajnerin Qatip Osmani, teksa Shkëndija renditet e fundit në kampionatin maqedonas. Ende asgjë nuk është zyrtare, por pritet që në orët në vijim drejtuesit e Shkëndijës të vendosin përfundimisht për emrin e ri të trajnerit.

Joshua: Ruiz, boksier lokalesh

Boksierët Anthony Joshua dhe Andy Ruiz Jr më 7 dhjetor do ta zhvillojnë revanshin për titujt kampionë bote. Titujt mbahen nga meksikani Ruiz, që më 1 qershor mposhti Joshuan me "KO teknik" në raundin e shtatë. Joshua, ish-kampion bote, u shpreh sot se, pasi t'i rimarrë titujt kampionë, është gati t'i mbrojë ato ndaj Tyson Fury, në një duel mes dy boksierëve britanikë. "Më 7 dhjetor do të dueloj me një boksier 'pub'-esh për të rimarrë titujt, më pas të shohim", ka thënë Joshua. "Unë jam gati të përballem më pas me çdo boksier tjetër që është në listë, përfshirë edhe Tyson Fury. Pse jo, ai mund të jetë rivali i parë i 2020-s. Nuk më tremb askush. Në këtë divizion ka shumë konkurrencë dhe dua t'i mposht të gjithë një e nga një", u shpreh Joshua.

Presidenti i La Ligas: Ronaldo dhe Mourinho të rikthehen në Spanjë

Cristiano Ronaldos dhe Jose Mourinhos u është kërkuar që të kthehen sërish në futbollin spanjoll nga presidenti i La Ligas, Javier Tebas. Pesë herë fituesi i "Topit të Artë", në verën e vitit 2018 u largua nga Real Madrid, për t'iu bashkuar Juventusit, ndërsa Jose Mourinho nuk ka drejtuar asnjë skuadër spanjolle që pas largimit nga 'Los Blancos', në vitin 2013. "Do të më pëlqente të kthehej përsëri Cristiano Ronaldo dhe që Jose Mourinho të ishte trajner i një skuadre spanjolle. Ai është një trajner i shkëlqyeshëm dhe një emër i mirë për ta promovuar ligën tonë", ka thënë Tebas.

Messi del në shitje nga vera e ardhshme

Duke filluar nga vera e vitit të ardhshëm të gjitha klubet do ta kenë shansin që të futen në garë për ta marrë yllin argjentinas Lionel Messi, nëse dhe buxheti ia lejon. Duke iu referuar asaj që raporton "El Pais", nga përfundimi i këtij sezoni Messi mund të vendosë të largohet vetë nga Barcelona në çdo kohë që mund të dëshirojë edhe pse ka një kontratë me skadencë në vitin 2021. Messi tani është në moshën 32-vjeçare dhe një largim i tij nga Barcelona ka filluar të mendohet nga të dyja palët. Sipas "El Pais", katalanasit dhe ylli argjentinas kanë arritur një marrëveshje, e cila i jep të drejtën Mesit të largohet nga "Camp Nou", në fund të çdo sezoni. Klubi spanjoll i ka bërë me dije lojtarit se ai ka dritën jeshile të largohet kur të dojë, nëse dëshiron të ndryshojë ambient. Është arritur një pakt që nëse sulmuesi kërkon largimin, atëherë Barcelona do ta lërë të lirë në çdo fund sezoni. Megjithatë, në kampin katalanas nuk i tremben aspak largimit të yllit argjentinas, pasi për çdo skuadër evropiane afrimi i Messit do të ishte një barrë shumë e rëndë financiare.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA I LUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. Nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Biblioteka

Institucioni: Biblioteka e te verberve "Syri Yne"

Divizioni: I Librit dhe Botimeve

Kategoria funksionale: Koeficienti : 7

Numri i referencës: 61/2019

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit të Librit dhe Botimeve

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit të Librit dhe Botimeve kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
2. Kryen detyrat të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga niveli më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diploma universitare, në shkencat shoqërore, mardhenie nderkombetare, fakulteti juridik, ekonomik, gjuhë dhe letërsi, fakulteti i edukimit minimum 4 vite përvojë punë profesionale;
2. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
3. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
4. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
5. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
6. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Procedurat e konkurimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 15 (pesëmbdhjetë) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 20.09.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereza" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës". Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA I LUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Z. br.03/L-149 i Uredbe br.02/2010, o Procedurama Rekrutiranja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo kulture, omladine i sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik za Biblioteku

Institucija: Biblioteka za slepa lica "Syri Yne"

Divizija: Knjige i Izdanja

Funkcionalna kategorija: Koeficijent : 7

Referentni broj: 61/2019

Odgovara: Rukovodiocu Divizije za Knjige i Izdanja

Mesto: Priština

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom Rukovodioca Knjige i Izdanja, obavlja dole navedene dužnosti i odgovornosti:

1. Razvija i odobrava planove rada i rokove sa menadžerom i drugim stručnim osobljem za sprovođenje relevantnih usluga i proizvoda;
2. Obavlja specijalizovane zadatke, prema zahtevima, iz specifične profesionalne oblasti u skladu sa važećim zakonima, uredbama, politikama i procedurama, unutar određenih vremenskih rokova;
3. Obavlja zadatke iz specifične, profesionalne oblasti, sa jednim razlozom stepenom samostalnosti, s povremenim nadzorom i uputstvima;
4. Vršiti istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju preporuka za razmatranje od najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama iz specifične profesionalne oblasti, kada se tako nešto zahteva.
6. Komunicira unutar i van institucije o razmeni informacija i razvoja delatnosti iz oblasti zajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa, u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične i profesionalne delatnosti, koja mogu da se zahtevaju na razlozan način, s vremena na vreme.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Univerzitetska diploma iz društvenih nauka, međunarodnih odnosa, pravnog fakulteta, ekonomije, jezika i književnosti, obrazovnog fakulteta sa najmanje 4 godine profesionalnog iskustva;
2. Duboko i specijalizovano znanje iz specifične stručne oblasti stečeno univerzitetskim obrazovanjem i odgovarajućih obuka;
3. Poznavanje važećih zakona i uredba;
4. Komunikacijske veštine i planiranje rada, eventualne koordinacije osoblja na administrativnom nivou;
5. Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formuliranje preporuka i stručnih saveta;
6. Veštine iz kompjuterski softverski programa (Word, Excel, Power Point, Access);

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeni rok.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 15 (petnaest) dana.

Zadnji datum za apliciranje je: 20.09.2019

Aplikacije koje se šalju putem pošte, sa poštanskim markicama, na poslednji datum konkursa, smatraju se važećim.

Podnošenja zahteva: Aplikacija se uzima i predaje u kancelariji broj 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza", Br. 44. Za dodatne informacije, kontaktirajte broj 038211449 i 038 211921 (ili na veb-stranici <http://www.mkrs-ks.org/>). Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog i od svih zajednica na Kosovu. Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe unutar javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Članu 11. Stav 3, Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova. Aplikacije poslate nakon zadnjeg datuma kao i ne kompletirani aplikacije, neće se primiti. Zbog velikog broja primljenih aplikacija, kontaktiraće se samo kandidati koji su odabrani u užoj listi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Administratës Publike – Ministarstvo Javne Administracije
Ministry of Public Administration

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ,L. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall:

KONKURS

Departamenti: Standardeve Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ)

Titulli i punës: Zyrtar i Mirëmbajtjes së Sistemeve (1 vend pune)
Nr.ref.RN00005561

Kategoria funksionale: Nivel Profesional

Koeficienti: 6

Lloji i pozitës: i Karrierës

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunësi i karrierës (përhershëm) - periudha provuese: dymbëdhjetë (12) muaj

Vendi i punës: Prishtinë ndërtesa "ish Rilindja"

Qëllimi i vendit të punës: Mbikëqyrjen dhe koordinimin e kontrollit të mirëmbajtjes së ndërtesave qeveritare.

Nëpunësi raporton te: Udhëheqësi i Divizionit

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Të mbikëqyrë dhe merrë masat e duhura për realizimin e planeve periodike të kontrollit të mirëmbajtjes, në veçanti mirëmbajtjen higjienike, largimin e mbeturinave në ndërtesat qeveritare;
2. Të mbikëqyrë dhe merrë masat e duhura duke koordinuar realizimin e punëve të mirëmbajtjes teknike në ndërtesat qeveritare;
3. Të koordinon punët për bartjet e ndryshme duke përfshirë edhe akomodimet;
4. Të azhuroj shënime teknike në bazën e shënimeve duke bërë evidentime periodike për intervenimet në pajisje dhe sisteme;
5. Të koordinoj dhe ngrit nivelin e bashkëpunimit dhe profesionalizmin në kryerjen e aktiviteteve të njësisë dhe me gjerë;
6. Të harmonizoj punët me njësit në kuadër të DMN dhe ma gjerë lidhur me aktivitetet e përbashkëta si në aspektin e realizimit të punëve të akomodimit ashtu edhe për mirëmbajtjen higjienike të hapësirave të brendshme dhe të jashtme;
7. Të përpilojë raporte periodike dhe sipas kërkesave;

Kualifikimi dhe përvoja

- Diplomë Universitare pa përvoja pune ose shkolla e lartë dhe dy (2) vite përvoja pune; Aftësi për punë në ekip, dhe përmbytje të detyrave dhe punëve të vështira.
- Aftësi të mira komunikuese;
- Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare;
- Njohuri të mirë pune me kompjuter (Word, Excel, Internet etj).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Ministria e Administratës Publike/ Zyra e Personelit, ish-ndërtesa e „Rilindja“ kati III (tretë), zyra nr. 320, Prishtinë, Kosovë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në nr. e tel: 038 / 200-60-404 ose 038 - 200 -30 -552, prej orës 08:00 – 16:00.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

